**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria –Vlada-Government**

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**

**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**

**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**

**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

# ANALIZË DHE HULUMTIM: OFRIMI I KURSEVE AFATSHKURTËRA (MODULARE) NË ARSIMIN PËR TË RRITUR

Prishtinë, tetor 2022

**Republika e Kosovës**

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria –Vlada-Government**

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**

**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**

**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**

**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

**Publikuar nga:**

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr)

**Autorët:**

Jetmir Berisha
Muhamer Ibriqi

**Ky hulumtim u realizua me mbështetjen e:**

BMZ Bundesministerium für wirtschaftliche Zusammenarbeit und Entwicklung

vhs DVV International

# PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave ... 5
Lista e tabelave dhe figurave ... 6
**1. HYRJE** ... 8
1.1. Bashkëpunimi i DVV International me AAAPARr ... 10
**2. RËNDËSIA E OFRIMIT TË KURSEVE AFATSHKURTËRA** ... 12
**3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT** ... 16
**4. RREGULLIMI DHE BAZA LIGJORE PËR OFRIMIN E KURSEVE AFATSHKURTRA (MODULARE)** ... 18
**5. PËRGATITJA E PYETËSORIT** ... 19
**6. ANALIZA E PËRGJIGJEVE NË PYETJET E PYETËSORIT** ... 27
6.1. Nevojat për rregullimin e bazës ligjore për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) ... 27
6.2. Aktet ligjore dhe nënligjore për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) ... 28
6.3. Baza ligjore për rekrutimin e mësimdhënësve dhe instruktorëve për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr ... 29
6.4. Kapacitetet profesionale, infrastrukturore dhe financiare për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) ... 30
6.5. Rregullorja për rregullimin e të hyrave vetanake ... 31
6.6. Nevoja për ndryshime të dokumentacionit pedagogjik ... 32
6.7. Rrethanat lehtësuese që do të mundësonin ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr në institucionin përkatës ... 33
6.8. Gatishmëria e institucioneve përkatëse për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr ... 34
6.9. Profesionet më të kërkuara në tregun e punës ... 35
6.10. Çfarë ofrojnë institucionet përkatëse për zbatimin e rregullt të programeve të kurseve afatshkurtra (modulare) në rast të kërkesës? ... 37
6.11. Aspektet e mësimdhënies dhe të nxënit ... 38

6.12. Nevojat për ngritjen e bashkëpunimit publiko-privat për kryerjen e praktikës profesionale, gjatë implementimit të kurseve afatshkurtra (modulare) ..... 47
6.13. Përfitimet e kompanive gjatë bashkëpunimit në zbatimin e programeve afatshkurtra (modulare) të ARr ..... 48
6.14. Trajnimet e nevojshme për stafin e angazhuar në kurset afatshkurtra (modulare) në ARr ..... 49
6.15. Ofrimi i trajnimeve shtesë për mësimdhënësit ..... 50
6.16. Format e organizimit të mësimit me rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr ..... 51
6.17. Përparësitë e formës së organizimit të mësimit me rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr ..... 53
6.18. Kohëzgjatja e përgatitjeve për të filluar më regjistrimin e kandidatëve në kurset afatshkurtra (modulare) ..... 54
6.19. Kushtet teknike dhe profesionale në institucionet përkatëse ..... 54
6.20. Shfrytëzimi i të hyrave vetanake nga ofrimi i arsimit për të rritur ..... 61
6.21. Çfarë mund t'u ofrojnë institucionet përkatëse kandidatëve të interesuar para pranimit për pjesëmarrje në kurse afatshkurtra? ..... 63
6.22. Kriteret e pranimit në kurset afatshkurtra (modulare) ..... 64
6.23. Përfitimet e kandidatëve nga ofrimi i programeve afatshkurtra (modulare) në ARr ..... 64
6.24. Nevoja për përfshirjen e instruktorëve të kompanive që bashkëpunojnë me shkollën në procesin e vlerësimit të kandidatëve ..... 65
6.25. Sfidat me të cilat mund të përballen institucionet përkatëse në rastin e zbatimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr ..... 66
6.26. Vlerësimi i elementeve këshilluese dhe udhëzuese në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) ..... 67
6.27. Masat që duhet të merren për lansimin e suksesshëm të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr ..... 69
6.28. Kriteret e vlerësimit dhe monitorimit në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr ..... 70
**7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME** ..... 72

## Lista e shkurtesave

| | |
|---|---|
| MAShTI | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit |
| AAAPARr | Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur |
| AKK | Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve |
| IPK | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| QK | Qendra e Kompetencës |
| ShMLP | Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale |
| ShMLT | Shkolla e Mesme e Lartë Teknike |
| IAAP | Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional |
| IAL | Institucioni i Arsimit të Lartë |
| DVV | DVV International - Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqatës së Shkollave Popullore Gjermane |
| ETF | European Training Foundation |
| CEDEFOP | European Center for the Development of Vocational Training |
| ILO | International Labour Office |
| SKZh | Strategjia Kombëtare për Zhvillim |
| KKK | Korniza Kombëtare e Kualifikimeve |
| PSAK | Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë |
| MTPT | Ish- Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit |
| MI | Ministria e Infrastrukturës |
| ARr | Arsimi për të Rritur |
| UA | Udhëzimi Administrativ |
| INK | Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit |
| IUK | Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit |
| TIK | Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit |

## Lista e tabelave dhe figurave


1. **Tabela 1:** Pyetësori

2. **Figura 1:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 3 të pyetësorit

3. **Figura 2:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 5 të pyetësorit

4. **Figura 3:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 8 të pyetësorit

5. **Figura 4:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 9 të pyetësorit

6. **Figura 5:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket punës në grupe

7. **Figura 6:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket mësimit në distancë

8. **Figura 7:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket ligjëratave

9. **Figura 8:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket praktikës profesionale

10. **Figura 9:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket mësimit me projekte ose të nxënit e orientuar në zgjidhjen e problemeve

11. **Figura 10:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket mbajtjes së shënimeve

12. **Figura 11:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket prezantimeve të kandidatëve

13. **Figura 12:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket aktiviteteve vetë-studim

14. **Figura 13:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket vlerësimit të kursit nga ana e kandidatëve

15. **Figura 14:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket komunikimit të respektueshëm ndërmjet mësimdhënësit dhe kandidatit

16. **Figura 15:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 15 të pyetësorit

17. **Figura 16:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 16 të pyetësorit

18. **Figura 17:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket kushteve në klasat e mësimit

19. **Figura 18:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket kushteve në punëtoritë për organizimin e praktikës profesionale

20. **Figura 19:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket qasjes së mundshme në internet

21. **Figura 20:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket mundësive për konsultim me stafin mësimdhënës

22. **Figura 21:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket cilësisë së pajisjeve në punëtoritë për kryerjen e praktikës profesionale

23. **Figura 22:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket kushteve në laboratorët e TIK-ut

24. **Figura 23:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket furnizimit me materialet mësimore

25. **Figura 24:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 21 të pyetësorit

26. **Figura 25:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 26 të pyetësorit, sa i përket këshillave dhe udhëzimeve profesionale të ofruara nga stafi (mësimdhënësit)

27. **Figura 26:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 26 të pyetësorit, sa i përket diskutimeve (konsultimeve) të provimeve me shkrim, detyrave, vlerësimeve praktike, etj.

28. **Figura 27:** Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 26 të pyetësorit, sa i përket këshillave profesionale individuale në fushën e kursit të ofruar

# 1. HYRJE

Arsimi dhe Aftësimi i të Rriturve është një ndër komponentët mjaft të rëndësishëm në sistemin arsimor të një vendi. Përmes ofrimit dhe zhvillimit të Arsimit të të Rriturve si formë e zhvillimit të të mësuarit gjatë gjithë jetës, mundësohet që individëve të pakualifikuar, personave të papunë, grupeve te margjinalizuara dhe të painkuadruar, të zhvillojnë karrierën e tyre profesionale për punë, rikualifikim dhe zhvillim të mëtutjeshëm. Mësimi gjatë gjithë jetës si qasje ende nuk e ka gjetur zbatimin e duhur në sistemin arsimor të vendit, për të mundësuar reformimin në arritjen e kualifikimeve në arsimin e të rriturve.

Qasja aktuale në arsimin e të rriturve është pothuajse e kufizuar vetëm në arsimin formal, të përshpejtuar dhe kompenzues që ofrohet në IAAP-të publike. Kjo formë e ofrimit të arsimit për të rritur zbatohet për kandidatët nga mosha 18 vjeç e tutje, me programe të shkurtuara nga ofrimi i arsimit të rregullt. Kjo formë e arsimit të përshpejtuar me provime, kundrejt një pagese të caktuar për një vit shkollor është qasje e cila kandidatëve iu mundëson shtigje të kalueshmërisë në nivele tjera të arsimit përmes provimit të maturës, pa pasur një filtër shtesë të kalueshmërisë, duke u barazuar kështu me nxënësit që përfundojnë nivele të rregullta të shkollimit. Për më tepër, ende nuk ka një rregullim dhe instrument vlerësues lidhur me kërkesat e tregut të punës dhe hulumtimin e tregut për ofrimin e profileve në IAAP-të si programe formale për ARr, në nivel vendi.

Kjo qasje e kufizuar ka shkaktuar mungesë të ofertës, duke mos rregulluar modalitetet tjera të arsimit për të rritur që mund të ofrohen nga IAAP-të, siç janë kurset afatshkurtra (modulare) bazuar në njohjen e mësimit paraprak ose bazuar në kërkesat specifike të kandidatëve të interesuar.

Një formë mjaftë produktive dhe e kërkuar nga tregu i punës në arsimin e të rriturve është edhe ofrimi i kurseve afatshkurtra (modulare) për persona dhe grupe të ndryshme, me qëllim të inkuadrimit të tyre në tregun e punës, duke u bërë kështu individ dhe grupe të rëndësishme në shoqëri.

Sistemi i arsimit në Kosovë viteve të fundit po bënë përpjekje më të mëdha që ndryshimet në drejtim të përmirësimit të gjendjes të jenë më të shpejta. Sa më parë që arrihet përmbushja e një numri të konsiderueshëm të sfidave dhe nevojave të ekonomisë së tregut aq më shumë do t'i afrohemi përmbushjes së objektivave që dalin nga dokumente të shumta të përgatitura nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe institucioneve tjera relevante në vend, të ndihmuara nga ekspertiza e vendeve më të zhvilluara të Bashkimit Evropian. Shumica e dokumenteve ekzistuese në lidhje me arsimin në Kosovë e sidomos dokumentet e përgatitura për arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin për të rritur theksojnë nevojën e bashkëpunimit më të madh ndërmjet shkollave

profesionale dhe komunitetit të bizneseve nëpër regjionet ku ato ndodhen, me qëllim të përshtatjes sa më të madhe të ofertës së profileve arsimore në shkollat profesionale me kërkesën e sektorëve ekonomik më të zhvilluar në ato regjione.

AAAPARr si institucion ka për synim mbështetjen në mënyrë të fuqishme zhvillimin e AAP-së dhe ARr-së në Kosovë, që në përputhje me standardet evropiane të mundësojë:

- Zhvillimin dhe përmirësimin e komponentës së arsimit për të rritur në arsim formal, jo formal dhe informal,
- Rritjen e ofertës për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në IAAP,
- Zhvillimin e kurseve afatshkurtra (modulare) për ofruesit e ARr-së,
- Përmbushjen e nevojave të kandidatëve dhe grupeve të ndryshme krahas ndryshimeve të zhvillimit të teknologjisë moderne dhe zhvillimit ekonomik e social të vendit,
- Sigurimin e partneritetit social në të gjitha fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të ARr-së,
- Integrimin e arsimit, aftësimit dhe punës në këndvështrimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës,
- Zhvillimin e dimensionit Evropian të AAP-së, duke siguruar një transparencë të kualifikimeve dhe përafrimit të kompetencave me tregun e përbashkët Evropian.

AAAPARr në Kosovë që nga fillimi i vitit 2016 është anëtare e Asociacionit Evropian të Instituteve për Aftësim Profesional (EVBB) me seli ne Bruksel e cila është organizatë ombrellë, anëtare të së cilës janë organizata dhe Institucione te ndryshme shtetërore nga vendet e ndryshme Evropiane, institute koordinuese të arsimit dhe ofruesit e arsimit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Objektiva kryesore e punës së EVBB-së është përmirësimi i cilësisë të arsimit dhe aftësimit profesional në vendet Evropiane, krijimi i mundësive dhe kushteve për një fuqi punëtore mobile me shkathtësi të duhura profesionale sipas kërkesave të tregut Evropian.

Duke qenë të vetëdijshëm për sfidat e reja në gjithë botën, për dukuritë me ndikim shumë të madh në zhvillimet arsimore, ekonomike, sociale e politike, themelimi i AAAPARr-së vie si përgjigje e këtyre zhvillimeve, prandaj agjencia ndër të tjera në kuadër të kompetencave të veta që ka si institucion, ka synim që në shkollat profesionale të bëjë të mundur ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) si një formë e përgatitjes së kuadrove për treg të punës. Ndër të tjera, në këtë formë AAAPARr, synon reformimin e sektorit të arsimit profesional dhe arsimit të të rriturve, me qëllim që shkathtësitë e fituara

të nxënësve dhe kompetencat e tyre të jenë ekuivalente me ato të bashkëmoshatarëve të tyre që dalin nga sistemet arsimore të shteteve të BE-së. Në vitet e fundit, Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI), e mbështetur nga donatorët, ka nisur reforma në sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimin e të rriturve në Kosovë dhe si rezultat i këtyre reformave, janë themeluar Qendrat e Kompetencës të financuara nga Qeveria e Norvegjisë dhe ajo e Luksemburgut. Qendrat e Kompetencës dallojnë nga shkollat tjera profesionale për nga infrastruktura moderne, pajisjet, cilësia e mësimdhënies, realizimi i aftësimit praktik të nxënësve, bashkëpunimi me bizneset, zbatimi i kurrikulave modulare, bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare si dhe në zhvillimin e modelit të biznesit. Deri më tani në Kosovë ekzistojnë gjashtë shkolla profesionale (Qendra të Kompetencës) nën menaxhimin e AAAPARr-së: Qendra e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, Qendra e Kompetencës “11 Marsi” në Prizren, Qendra e Kompetencës në Skenderaj, Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, Qendra e Kompetencës në Ferizaj dhe Qendra e Kompetencës në Prizren, të cilat kanë edhe rolin multifunksional, ku përveç programeve të rregullta tre-vjeçare janë në rrugë të duhur për të ofruar edhe kurse të shkurtra për të gjithë të rriturit të cilët kanë nevojë të marrin një kualifikim të ri, të rikualifikohen apo t’i avancojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre dhe t’u përgjigjen sa më mirë nevojave të tregut të punës. Si rrjedhojë e kësaj, për herë të parë në sistemin formal të arsimit në Kosovë, AAAPARr ka startuar nivelin e pestë të kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” dhe “Këshilltar në karrierë“ që janë zhvilluar nga PEARSON, institucion prestigjioz britanik, ndërsa është financuar nga projekti “Lux Development”.

Së fundmi, AAAPARr e ka realizuar këtë hulumtim me mbështetjen teknike dhe profesionale të zyrës së Institutit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Shoqatës së Shkollave Popullore Gjermane në Kosovë, të njohur si DVV International, përmes projektit “Zhvillimi i programeve afatshkurtra (modulare) të arsimit për të rritur dhe përdorimi i këtyre programeve në kuadër të 6 Qendrave të Kompetencës (QK) dhe shkollave të mesme Profesionale (ShKMP) në Kosovë”.

## 1.1. Bashkëpunimi i DVV International me AAAPARr

DVV International në Kosovë është duke mbështetur dhe zhvilluar edukimin e të rriturve që nga viti 2005. Qëllimi i DVV International është ndërtimi i një sistemi arsimor efektiv dhe cilësor për arsimin e të rriturve dhe mësimin gjatë gjithë jetës.

DVV International mbështet përpjekjet shtetërore në mbarë botën për të siguruar dhe implementuar strategjitë e arsimit të të rriturve si mjet në luftën kundër varfërisë. Prandaj DVV International në

Kosovë kualifikon vendimmarrësit në angazhimin e tyre me qasjet rajonale dhe ndërkombëtare si pjesë e procesit të vazhdimit të Konventës ndërkombëtare VI - Konferenca Ndërkombëtare për Arsimin e të Rriturve - por edhe në lidhje me kërkesat që dalin nga perspektiva e anëtarësimit në BE. Çështjet kryesore këtu janë financimi i arsimit të të rriturve përmes buxhetit publik, rritja e cilësisë dhe mundësive për të mësuarit e të rriturve (validimi dhe akreditimi i institucioneve dhe kurseve), si dhe sigurimi i pjesëmarrjes jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse të të rriturve në procesin arsimor .

Fokusi kryesor i punës së DVV International në bashkëpunim me AAAPARr është i orientuar në trajnimin mësimdhënësve dhe trajnerëve në metodologjinë dhe didaktikën e arsimit të të rriturve me qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të arsimit profesional për të rritur në kuadër të shkollave të mesme profesionale dhe QK.

Në kuadër të bashkëpunimit shumëvjeçar DVV International me AAAPARr në fushën e arsimit për të rritur kanë hartuar dhe zhvilluar standardet e profesionit dhe kurrikulat në profilet arsimore: Metalpunues, Rrobaqepësi, Automekanik dhe Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit, të cilat do të shërbejnë në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës për të ofruar një qasje modulare të avancuar dhe kompatibil me kërkesat e tregut të punës. Ky bashkëpunim do të ngrisë nivelin e performancës dhe sigurimit të cilësisë në shkollat e mesme profesionale përmes zbatimit të këtyre kurrikulave në funksion të punësimit.

Nevoja e të kuptuarit më të mirë të këtyre lëvizjeve dinamike në tregun e punës kryesisht vie si rezultat i zhvillimit të hovshëm të teknologjisë, duke ndikuar gjithashtu në një masë të madhe te ndryshimi i agjendave politike arsimore në shumë vende të botës.

Në vitet e fundit jo vetëm në vendin tonë por në përgjithësi në nivel global tregjet po pësojnë një lëvizje mjaftë dinamike dhe komplekse të punëve dhe të aftësive për të kryer punë, duke kërkuar përshtatje më të shpejtë dhe përputhje sa më të mirë të ofertës në shkollat e arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës. Një nga sfidat më të mëdha të viteve të fundit për shkak të pandemisë globale është edhe nevoja për ofrimin e arsimit dhe aftësimit profesional përmes digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve, duke përdorur platforma të ndryshme. Kësaj sfide AAAPARr në bashkëpunim me DVV i është përgjigjur duke hartuar dy platforma elektronike për ofrimin e arsimit për të rritur përmes përdorimit të platformave online (nga distanca). Profilet “Marketing” dhe “TIK” në dy Qendrat e Kompetencës në Prizren dhe Malishevë janë dy profilet arsimore të para në sistemin formal parauniversitar në Kosovë në të cilat ofrohet kjo formë e mësimit për të rritur.

## 2. RËNDËSIA E OFRIMIT TË KURSEVE AFATSHKURTËRA

Hulumtimi lidhur me nevojën e ofrimit dhe zbatimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në IAAP, do të shërbejë për nevojat e AAAPARr-së, MAShTI-it dhe akterëve tjerë në Kosovë, si një udhërrëfyes për zhvillimin e kurrikulave dhe programeve të nevojshme arsimore për këtë komponent të kualifikimeve, duke u bazuar në specifikat e tregut të punës në vend, me qëllim të ofrimit gjithashtu të informacioneve për nevojat e ndërtimit të kapaciteteve të IAAP-ve. Realizimi i këtij hulumtimi dhe analize do të na ndihmojë për të parë mundësitë e shkollave se sa janë në gjendje të fillojnë zbatimin e kurseve afatshkurtra (modulare), si një formë e re e ofrimit të ARr-së.

• **Relevanca e ndërlidhjes me dokumente strategjike**

Ekzistojnë dokumente referente apo strategji të ndryshme në nivel qeveritar, ministror dhe komunal të cilat mundohen të orientojnë ecurinë e zhvillimit të arsimit të të rriturve , duke paraqitur konkretisht misionin, vizionin, objektivat strategjike, masat dhe treguesit. Në dokumentet e tilla strategjike janë paraqitur gjithashtu planet e zbatimit të këtyre strategjive, duke paraparë buxhete, periudha të zbatimit, bartësit dhe prioritetet për secilën nga masat e parapara. Megjithatë mund të thuhet se në shumicën e këtyre dokumenteve nuk ka një trajtim të mjaftueshëm adekuat dhe konkret edhe për komponentën e kurseve afatshkurtra (modulare). Dokument i rëndësishëm që flet për mundësinë e zbatimit të Arsimit për të Rritur, në kuadër të shkathtësive për punë është Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH), dokument zyrtar i Qeverisë së Kosovës, si plan për një zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë dokument më tej thuhet se: Qeveria duhet të themelojë programe formale të AAP-së pas shkollës së mesme brenda Qendrave te Kompetencës me programe fleksibile për të përmbushur nevojat e ndryshimit dhe zhvillimit personal dhe për të inkurajuar shkollat që të ofrojnë kurse për të rriturit jashtë orarit normal të shkollës, sipas pagesës.

Tutje, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2022-26, si dokument i orientimit dhe zbatimit të politikave arsimore të të gjitha niveleve, parasheh rishikimin dhe plotësimin e kornizës ligjore në Arsimin e të Rriturve. Ndër të tjera në kuadër të identifikimit te nevojave për intervenim në PSAK, trajtohet edhe zhvillimi dhe ofrimi i kualifikimeve modulare si dhe kurseve jo-formale të ARr në IAAP, hartimi dhe akreditimi i programeve të niveleve të ndryshme.

Përmes këtij hulumtimi tentohet të fillohet hapja e një dritareje informuese për gjendjen në të cilën gjendet ARr dhe mundësit e zbatimit të komponentës së programeve të shkurtra modulare me shpresën se në të ardhmen do të kemi edhe hulumtime tjera në këtë drejtim, e posaçërisht hulumtime të thelluara

më tepër në nevojën e tregut të punës dhe raportet me ofertën e IAAP-ve. Nismëtarët e kësaj iniciative (AAAPARr në bashkëpunim me DVV-International) janë të vetëdijshëm se kjo nismë nuk e plotëson në tërësi zbrazëtinë ekzistuese për informacionin e nevojshëm në lidhje me mundësinë e zbatimit të kurseve afatshkurtër (modulare), pasi në të ardhmen do të jetë e domosdoshme të punohet gjithashtu me ofruesit dhe akterët relevant që operojnë në sektorë të ndryshëm ekonomik në nivel regjional.

• **Njohja e Mësimit Paraprak në kontekstin e ofrimit të kurseve afatshkurtra**

Njohja e Mësimit Paraprak është proces i vlerësimit të njohurive të fituara përmes mësimit formal, joformal dhe informal, në punë apo përmes aktiviteteve tjera.

Bazë për rregullimin e NJMP-së është Ligji Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare në Republikën e Kosovës dhe udhëzimet administrative: UA. Nr. 35/2014 lidhur me kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Udhëzimi Administrativ Nr. 31/2014 për Njohjen e Mësimit Paraprak, përgjegjësitë dhe procedurat e përgjithshme për validimin e mësimit joformal dhe informal në të gjitha nivelet duke përfshirë AAP-në, arsimin e përgjithshëm dhe arsimin e lartë.

Përkundër disa zhvillimeve pozitive gjatë periudhës së fundit në aspektin e rregullimit të Njohjes së Mësimit Paraprak, deri më tani vetëm pak institucione të AAP-së janë akredituar për NjMP nga AKK dhe së fundi janë certifikuar disa mësimdhënës si koordinatorë, mentorë dhe vlerësues. Kapacitetet e kufizuara i pamundësojnë IAAP-ve të zhvillojnë/ofrojnë profile të reja për ARr. Siç e kemi potencuar, programet aktuale për ARr që ofrohen në IAAP përmes mësimit të përshpejtuar/kompenzues bazohen në kurrikulat e njëjta që janë në zbatim për mësimin e rregullt, pra nevojitet të përgatiten kurrikula të veçanta për ARr për nivelet e ndryshme arsimore. Krahas kësaj, duhet të zhvillohet edhe oferta për kualifikime afatshkurtra dhe kurse jo-formale që mundësojnë zhvillim të vazhdueshëm profesional, ri-aftësim, njohuri dhe shkathtësi për progres në jetë, punë apo në shkollim[1]. Për këtë qëllim, ngritja e kapaciteteve të IAAP-ve për zbatimi i NjMP do të ndikonte pozitivisht në ofrimin e programeve të ARr dhe modaliteteve të tij për të iu mundësuar personave arritjen e kaulifikimeve përmes procesit të identifikimit dhe vlerësimit të njohurive, shkathtësive dhe përvojës së tyre të fituar përmes mësimit, punës dhe aktiviteteve.

Nga ana tjetër, me qëllim plotësimin e ofertës për programe të ARr, MASHTI në bazë vjetore duhet të shpallë ofertë për projekt-propozime për ofruesit formal dhe jo-formal dhe të ndaj fonde për ofrimin e programeve të ARr.

1 Strategjia e Arsimit në Kosovë 2022-2026

**• Procesi i validimit dhe akreditimit**

Për të ofruar NJMP për kandidat, një ofrues në këtë rast IAAP-të duhet të jenë të akredituara dhe të kenë programe të validuara nga AKK për të qenë në gjendje të ofrojë NjMP për certifikim. Ky proces siguron cilësi, transparencë dhe siguri të ofruesve për kandidatët e interesuar për NJMP, dhe njëkohësisht ngritë standardin e sigurimit të cilësisë dhe relevancës së kualifikimeve të kurseve afatshkurtra (modulare).

Në këtë proces ku bën pjesë gjithë komponenta e ARr-së, sfiduese është mungesa e kapaciteteve të pamjaftueshme të IAAP-ve për t'i plotësuar kriteret e kërkuara nga AKK dhe gjithashtu mungesa e kapaciteteve të kësaj të fundit për procesin e validimit dhe akreditimit[2]. Këto pengesa ndikojnë në mos përgjigjen e shpejtë ndaj kërkesave të tregut të punës dhe përformancën jo të mire të IAAP-ve.

**• Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në ARr**

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është gjithashtu komponentë shumë e rëndësishme që ndikon në cilësinë e ofrimit të programeve të ARr-së. Janë zhvilluar dhe ofruar trajnime të ndryshme në fushën e ARr-së por oferta për programe të aftësimit të mësimdhënësve ARr është ende e pamjaftueshme. Në këtë aspekt janë ofruar trajnime nga institucionet vendore dhe donatorët për Andragog si profesionist të ofrimit të shërbimeve në fushën e ARr. Tutje,mundësia e mësimdhënësve për të marrë pjesë në programe të ndryshme të mobilitetit dhe për të mësuar nga praktikat e mira në vendet tjera është shumë e vogël, për shkak se IAAP-të në masë shumë të vogël janë pjesë e projekteve që mbështesin mobilitetin. Sfidë tjetër paraqet edhe mungesa e standardit të profesionit dhe një kurrikule të mirëfilltë për kualifikimin e kuadrit për ARr. Mungesa e një programi kualifikues që përgatitë mësimdhënës për arsim për të rritur ka bërë që kuadri mësimdhënës për ARr të mos ketë kualifikimin dhe kapacitetet e nevojshme për ofrim dhe zbatim të ARr [3].

Një nga programet e avancuara në zhvillimin profesional të mësimdhënësve është "Curriculum globALE", i cili mbështet edukatorët në fushën e të rriturve në profesionalizimin e tyre duke ofruar qasje ndërkurrikulare. Duke mbështetur edukatorët e të rriturve, "Curriculum globALE", përmirëson standardin e ofrimit të programeve të mësimit dhe edukimit të të rriturve. Gjithsesi nevoja për të ofruar trajnime profesionale në fushën e ARr-së është evidente. Kësisoji, kjo ndihmon IAAP-të për zhvillim profesional të mësimdhënësve duke ofruar qasje invovative për zhvillim në fushën e Arsimit për të Rritur, me theks ofrimin e kurseve afatshkurtra.

2 Strategjia e Arsimit në Kosovë 2022-2026
3 Strategjia e Arsimit në Kosovë 2022-2026

**• Mbledhja e të dhënave për ofruesit e ARr**

Mbledhja e të dhënave për ofruesit në arsimin për rritur dhe arsimin gjatë gjithë jetës është sfidë pasi që kapaciteti për të mbledhur dhe përpunuar zhvillimet në sektorin e ARr-së janë të fragmentuara. Siç tregon baromoetri i tregut të punës, ofron të dhëna vetëm për numrin e personave që ndjekin arsim për të rritur formal në shkollat e AAP-së në Kosovë, por jo edhe të institucioneve tjera të AAP-së. Po ashtu mungojnë edhe të dhëna mbi gjurmimin e personave që kanë përfunduar programe të ARr [4]. Në këtë kontekst AAAPARr, si institucion që merret me fushën e AAP-së dhe ARr-së, para disa viteve ka filluar një qasje për të mbledhur të dhëna nga IAAP-të, për programet që ato ofrojnë në fushën e Arsimit për të Rritur, sa janë të zbatueshme ato programe, çfarë infrastrukture kanë, çfarë trajnime ofrohen për mësimdhënësit që punojnë në Arsimin e të Rriturve e çështje të tjera që janë relevante. Për ta bërë më përmbajtjesore këtë qasje AAAPARr ka krijuar një databazë në web faqen e saj me idenë që të regjistrohen në të, gjithë IAAP-të që ofrojnë Arsim për të Rritur. Krejt kjo për të mundësuar që të kemi të dhëna për ofruesit dhe për programet që ofrohen në to dhe që të jetë në dispozicion edhe për palët tjera të interesuara.

Gjithashtu është me rendësi edhe koordinimi dhe bashkërendimi ndër-institucional i politikave dhe aktiviteteve në qasjen dhe ofrimin e ARr-së, për të përmirësuar ofertën dhe për të nxitur pjesëmarrjen. Zyrat e punësimit në kuadër të komunave ofrojnë informata të rëndësishme, lidhur me kërkesat e fuqisë punëtore, kualifikimet dhe të papunët. Kjo ndihmon për të shkëmbyer informacione me institucionet relevante si IAAP-të dhe QAP-at, për mundësin e ofrimit të programeve të ndryshme në ARr.

**• Financimi i ARr-së**

Sa i përket financimit publik për ARr deri me tani mungon një linjë e veçantë buxhetore për ARr dhe gjithashtu mungon një qasje institucionale. Në IAAP-të publike fondet shpërndahen si pjesë e buxhetit të përgjithshëm të AAP-së. Në përgjithësi, planifikimi dhe zbatimi i masave për avancimin e ARr pengohet nga kufizimet financiare dhe në masë të madhe varet nga financimi i vazhdueshëm i donatorëve [5]. Kjo edhe ndikon në ofrimin dhe zbatimin e dobët të programeve cilësore të ARr-së, sepse mungesa e buxhetit të veçantë të planifikuar për këtë kategori ndikon në ofrimin e ofertës për kandidat që janë të interesuar për programe të ARr-së. Nga ajo çfarë kemi pa deri tani, të hyrat vetanake që krijohen nga ofrimi i ARr-së për mësimin e përshpejtuar/kompenzues në disa IAAP, ka telashe për t'u ekzekutuar dhe shfrytëzuar. Ekziston një rregullore e hartuar nga MAShTI, për shfrytëzimin e të hyrave vetanake në Arsimin për të Rritur, mirëpo ka nevojë të rishikohet për ofrimin e formave të ndryshme të ARr-së, siç është edhe ofrimi i kurseve afatshkurtra (modulare).

4 Strategjia e Arsimit në Kosovë 2022-2026
5 Strategjia e Arsimit në Kosovë 2022-2026

# 3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Hulumtimi është zhvilluar në formë anketimi, nëpërmjet pyetësorit dhe analizës, krahasimit e intervistës, i cili është hartuar posaçërisht për këtë qëllim nga ekspertët e angazhuar në këtë projekt dhe është aprovuar nga AAAPARr. Me anë të këtij hulumtimi mblidhen të dhëna të rëndësishme nga IAAP-të e përzgjedhura për bashkëpunim, lidhur me gjendjen në shkolla dhe mundësinë e zbatimit të kurseve afatshkurtra modulare në to. Këto të dhëna të mbledhura krijojnë mundësi për të bërë vlerësime, analiza dhe krahasime mes IAAP-ve, lidhur me ofrimin dhe zbatimin e programeve të shkurtra modulare por edhe për të identifikuar nevojat dhe  mundësitë e sistemit arsimor aktual në Kosovë lidhur me këtë komponent.

Për këtë qëllim pyetësori është zhvilluar dhe përmban kërkesa për informacione specifike rreth gjendjes aktuale në shkollat e AAP-së dhe mundësitë reale për realizimin e programeve të tilla. Ka qenë sfidë më vete përpilimi i pyetjeve të pyetësorit, pasi që ne arsimin publik në Kosovë, në IAAP, ende nuk ofrohet një formë e tillë e mësimit nga fusha e Arsimit për të Rritur, konkretisht kurset modulare për të rritur. Pyetësori përmban gjithsej 28 pyetje të cilat janë dizajnuara në atë mënyrë që të jenë të ndërlidhura me njëra tjetrën.

Në fillim pyetësori përmban informata lidhur me njohuritë që kanë shkollat në lidhje me kurset afatshkurtra (modulare) në Kosovë, duke përfshirë njohuritë e përgjithshme për këtë sistem, legjislacionin që e rregullon dhe rëndësinë e tij për zbatim në IAAP.

Pastaj, pyetësori përmban informata tjera të rëndësishme lidhur me kapacitetet ekzistuese, infrastrukturën, stafin e mësimdhënësve në shkollat e AAP-së, të anketuara për këtë qëllim, përkatësisht vlerësimin nga ana e tyre lidhur me mundësinë e zbatimit të këtyre programeve, duke përfshirë komponentën e mësimdhënies, e cila është mjaft e rëndësishme për zbatim të këtij niveli. Element tjetër i rëndësishëm i përfshirë në pyetësor është edhe analiza dhe marrja e informatave nga IAAP-të, lidhur me gatishmërinë e tyre për të ofruar këto kurse në profile të caktuara për të cilat ka kapacitete të duhura shkolla, duke u bazuar edhe në kërkesat e tregut të punës.

Tutje në pjesën e fundit të pyetësorit gjithashtu ekzistojnë informata të rëndësishme që kanë dhënë shkollat e AAP-së për mundësinë e bashkëpunimit të shkollave me kompanitë lidhur me marrëveshjet për pranimin e kandidatëve që do të ndjekin këtë nivel, për mundësin e kryerjes se praktikës profesionale. Gjithashtu përmes pyetësorit kërkohen informata lidhur me trajnimet që përfaqësuesit e shkollave mendojnë se duhet të kryhen nga ana e mësimdhënësve për të ligjëruar.

Hulumtimi është zhvilluar dhe menaxhuar nga ekspertët e projektit të angazhuar nga AAAPARr dhe DVV International në Kosovë. Për qëllim të hulumtimit është paraparë që të intervistohen edhe persona zyrtar nga institucionet relevante që merren me Arsim dhe Aftësim Profesional, përkatësisht që kanë zhvilluar dokumentacion apo që merren me ARr.

# 4. RREGULLIMI DHE BAZA LIGJORE PËR OFRIMIN E KURSEVE AFATSHKURTRA (MODULARE)

Arsimi për të Rritur në Kosovë është i rregulluar me anë të bazës ligjore dhe dokumenteve tjera strategjike që mundësojnë ofrimin e ARr-së përmes formave të parapara të kësaj fushe. Ekzistojnë dokumente të cilat në mënyrë të fragmentuar e rregullojnë zbatueshmërinë dhe funksionimin e Arsimit për të Rritur por nevojitet shumë punë në zgjerimin e ofertës për ofrimin e arsimit për të rritur në formë dhe përmbajtje, siç janë kurset afatshkurtra (modulare) dhe modalitetrt tjera të ARr-së.

Qëllimi i Ligjit për Arsim dhe Aftësim e të Rriturve Nr. 04/L-143 është të rregulloj tërësinë e proceseve për arsimimin dhe aftësimin e të rriturve, si pjesë përbërëse e sistemit arsimor në Kosovë. Në këtë kontekst rregullimi dhe ofrimi i kurseve afatshkurtra e ka bazë fillestare në këtë ligj.

Ligji për Kualifikime Kombëtare Nr. 03/L-060 thekson që MAShT apo edhe institucionet tjera përgjegjëse mund të kërkojnë programe publike të arsimit dhe aftësimit, që çojnë vetëm te kualifikimet e caktuara, të aprovuara nga AKK. Kjo rregullohet me akt nënligjor, që nxirret nga institucionet përgjegjëse.

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) është dokumenti kryesor për rregullimin e llojeve dhe niveleve të kualifikimeve që jepen në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional formal dhe joformal ne institucionet publike dhe private. Përpos niveleve tjera me KKK rregullohet edhe përshkrimi i niveleve për ARr, kriteret hyrëse dhe dalëse për to. KKK është mekanizëm kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve të dhëna brenda sistemit kombëtar të kualifikimeve, sipas llojeve të kualifikimeve dhe përshkruesve të nivelit.

Qendrat e Kompetencës janë një koncept i ri i institucioneve të AAP-së që kanë për qëllim lehtësimin e procesit të shmangies nga kurrikula e bazuar në përmbajtje në kurrikulë të bazuar në kompetenca, duke siguruar një përgatitje të shkëlqyer për tregun e punës. Qendrat kanë objekte të shkëlqyera, lidhje të mira me tregun e punës, dhe janë menduar të shërbejnë si modele për shkollat profesionale në Kosovë dhe rajon.

UA 05/2012 për Qendrat e Kompetencës flet për mundësin e ofrimit të kurseve afatshkurtra në arsimin për të Rritur në Qendrat e Kompetencës.

Pra, ekziston bazë ligjore dhe institucione e dokumente relevante që merren me fushën e ARr-së, por ende nuk kemi një politikë te qartë dhe dokumente të harmonizuara nga akterët relevant që do të shërbenin për zbatimin në mënyrë të duhur të kësaj komponente.

# 5. PËRGATITJA E PYETËSORIT

Ekipi i hulumtimit (grupi i punës) ka ndërmarrë disa hapa në përgatitjen e formatit të pyetësorit dhe hartimin e pyetjeve në këtë pyetësor. Nga ana e ekipit janë trajtuar disa formate të pyetësorëve të përdorur në hulumtime të ndryshme, janë trajtuar gjithashtu edhe dokumentet më të fundit të përgatitura me mbështetjen e DVV International, sikurse "Studimi për të nxënit dhe arsimin për të rritur në Kosovë" dhe "Anketa për arsimin për të rritur në Kosovë", përfshirë edhe dokumentin "Analiza dhe hulumtimi për nivelin e pestë të kualifikimeve arsimore në shkollat e AAP-së në Republikën e Kosovës". Modeli i këtij formati të pyetësorit më së shumti bazohet në udhëzuesin për parashikimin e përshtatjes së aftësive të kandidatëve me kërkesat e tregut të punës, të përgatitur nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF), në lidhje me kryerjen e studimeve hulumtuese. Udhëzuesi i tillë është përgatitur nga ETF në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Zhvillimin e Trajnimeve Profesionale (e njohur si CEDEFOP) dhe Zyrën Ndërkombëtare të Punës (e njohur si ILO). Dokumente tjera referente në të cilat është bazuar përgatitja e pyetësorit dhe hulumtimit në tërësi janë gjithashtu:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim – SKZh;
- Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës;
- Ligji për Arsimin Profesional;
- Ligji për Arsimin e të Rriturve;
- Rregullorja për realizimin e të hyrave vetanake;
- Treguesit e arsimit në Kosovë, përgatitur nga MAShT;
- Raportet vjetor statistikor me tregues arsimor;
- Statistikat e arsimit në Kosovë;
- Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale në Kosovë, raport studimi, përgatitur nga Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) dhe DVV International;
- Korniza e treguesve të arsimit në Kosovë;
- Analizë e Hulumtimit – përfshirja e të rinjëve në zhvillimin e arsimit profesional, e përgatitur nga Iniciativa për Progres (INPO);
- Të dhënat për periudhën gjatë pilotimit, përgatitur nga AAAPARr;
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë, 2022-2026

Pas vendimit për formatin e pyetësorit, grupi i punës ka përgatitur pyetjet për pyetësor duke lënë mundësinë e përgjigjeve të hapura dhe të mbyllura në disa prej tyre. Draft-formati i pyetësorit dhe pyetjet e përgatitura janë diskutuar me përfaqësues nga AAAPARr dhe DVV International, si dhe

përfaqësues të disa prej shkollave profesionale në takime të veçanta të organizuara enkas për këtë qëllim. Grupi i punës ka mirëprit komentet dhe rekomandimet në lidhje me formatin e pyetësorit dhe pyetjet në pyetësor dhe njëkohësisht i ka përfshirë në rishikimin e tij. Pyetësori i është drejtuar pastaj vetëm shkollave profesionale, përkatësisht menaxhmenteve të shkollave profesionale të cilat kanë marrë pjesë në punëtorinë e organizuar për shpërndarjen e informacionit në lidhje me planifikimin për nxjerrjen e një dokumenti të tillë, ku është diskutuar në lidhje me pritshmëritë e shkollave profesionale dhe nevojën për kryerjen e një hulumtimi të tillë.

Në tabelën në vijim ndodhet formati me pyetjet e përgatitura në pyetësorin i cili iu është drejtuar shkollave profesionale:

<table>
<tr><td colspan="7">Ju lutemi jepni vlerësimin tuaj për pyetjet e shënuara në tabelën e mëposhtme. Vlerësimet të jepen bazuar në opinionin tuaj apo të niveleve të vlerësimit sikurse në pyetjet në vijim:</td></tr>
<tr><td rowspan="2">1</td><td colspan="6">Në bazë të përvojës që keni në ofrimin e arsimit për të rritur, cilat janë nevojat për rregullimin e bazës ligjore për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në institucionin tuaj?</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td rowspan="2">2</td><td colspan="6">Cilat akte ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë (përmirësojnë) arsimin për të rritur, mendoni se duhet te nxirren apo rishikohen (plotësohen) për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare)?</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td rowspan="3">3</td><td rowspan="3">Sa është e mjaftueshme baza ligjore sa i përket rekrutimit të mësimdhënësve dhe instruktorëve për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur?</td><td colspan="5">Aspak<br>Shumë</td></tr>
<tr><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td></tr>
<tr><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td></tr>
<tr><td rowspan="2">4</td><td colspan="6">Sipas opinionit tuaj, çfarë duhet të ndryshoj apo plotësohet nga formati aktual i ofrimit të arsimit për të rritur, në mënyrë që ky model të ofrohet edhe te kurset afatshkurtra (modulare). Specifiko përmbushjen e kapaciteteve profesionale, kapacitete infrastrukturore dhe financiare</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
</table>

<table>
<tr><td rowspan="3">5</td><td rowspan="3">Sa mund t'i përgjigjet Rregullorja për rregullimin e të hyrave vetanake, nevojave për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur.</td><td colspan="5">Aspak<br>Shumë</td></tr>
<tr><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td></tr>
<tr><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td></tr>
<tr><td rowspan="2">6</td><td colspan="6">Në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, a duhet të pësojë ndryshime plotësimi i dokumentacionit pedagogjik, /Po, Jo/. Nëse po, përmendni ndryshimet që ju i mendoni.</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td rowspan="2">7</td><td colspan="6">Listoni disa rrethana lehtësuese që do të mundësonin ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur ne institucionin tuaj</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td rowspan="3">8</td><td rowspan="3">Bazuar në kapacitetet teknike dhe profesionale aktuale, sa është i gatshëm institucioni juaj të fillojë ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur?</td><td colspan="5">Aspak<br>Shumë</td></tr>
<tr><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td></tr>
<tr><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td></tr>
<tr><td rowspan="2">9</td><td colspan="6">Specifikoni të paktën tre profesionet më të kërkuara (sipas vlerësimit tuaj) në tregun e punës (duke filluar nga më i kërkuari), në rajonin ku është duke vepruar institucioni juaj arsimor</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td rowspan="2">10</td><td colspan="6">Nëse themi që ka kërkesa nga kandidatët dhe kompanitë për kurset modulare në arsimin për të rritur, çfarë ofron institucioni juaj për zbatimin e rregullt të programeve të kurseve afatshkurtra (modulare)?</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Sa janë të theksuara në institucionin tuaj aspektet e mëposhtme të mësimdhënies dhe të nxënit | | | | | |
| | | Aspak | | | | Në një masë shumë të lartë |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | Puna në grupe | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Mësim në distancë | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Ligjëratat | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Praktika profesionale | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Mësim me projekte ose të nxënit e orientuar në zgjidhjen e problemeve | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Mbajtja e shënimeve | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Prezantime të kandidatëve | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Aktivitete vetë-studim | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Vlerësimi i kursit nga ana e kandidatëve | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Komunikim i respektueshëm ndërmjet mësimdhënësit dhe kandidatit | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 12 | Rendit nevojat për ngritjen e bashkëpunimit publiko-privat për kryerjen e praktikës profesionale, gjatë implementimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, në kuadër të institucionit tuaj arsimor | | | | | |
| | | | | | | |

<table>
<tr><td rowspan="2">13</td><td colspan="6">Cilët janë përfitimet e kompanive gjatë bashkëpunimit në zbatimin e programeve afatshkurtra (modulare) të arsimit për të rritur, ne kuadër të institucionit tuaj arsimor. Çka ndikon në përmirësimin e bashkëpunimit?</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td rowspan="2">14</td><td colspan="6">Listo trajnimet e nevojshme (Andragogjike, metodike-didaktike apo profesionale) për stafin e angazhuar në kurset afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur në kuadër të institucionit tuaj arsimor</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td rowspan="3">15</td><td rowspan="3">Sipas opinionit tuaj, sa do ta pranonin mësimdhënësit ofrimin e trajnimeve shtesë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale, në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur</td><td colspan="5">Aspak<br>Shumë</td></tr>
<tr><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td></tr>
<tr><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td></tr>
<tr><td rowspan="4">16</td><td rowspan="4">Bazuar në kapacitetet teknike dhe profesionale në institucionin tuaj, cila nga format e organizimit të mësimit me rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, do të ishte më e përshtatshme:</td><td colspan="5">Mësimi do të organizohej në orar të njëjtë me ofrimin e mësimit të rregullt, sipas ndërrimeve</td></tr>
<tr><td colspan="5">Mësimi do të organizohej në orar të ndryshëm nga ofrimi i mësimit të rregullt</td></tr>
<tr><td colspan="5">Mësimi do të organizohej vetëm fundjavave</td></tr>
<tr><td colspan="5">Kandidatëve do t'i mundësohej përzgjedhja e alternativave të përmendura më sipër</td></tr>
<tr><td rowspan="2">17</td><td colspan="6">Bazuar në përgjigjen e pyetjes së mësipërme, listo përparësitë e alternativës së përzgjedhur, në lidhje me mënyrën e organizimin të mësimit që do t'u ofrohej kandidatëve në institucionin tuaj</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | Duke marrë parasysh kapacitetet aktuale teknike dhe profesionale në institucionin tuaj, shpjegoni se sa kohë do të merrnin përgatitjet e duhura për të filluar me regjistrimin e kandidatëve në kurset afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur | | | | | |
| | | | | | | |
| 19 | Si do t'i vlerësonit kushtet teknike dhe profesionale në institucionin tuaj | | | | | |
| | | Shumë të dobëta | | të | | Shumë mira |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | Kushtet në klasat e mësimit | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Kushtet në punëtoritë për organizimin e praktikës profesionale | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Qasja e mundshme në internet | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Mundësitë për konsultim me stafin mësimdhënës | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Cilësia e pajisjeve në punëtoritë për kryerjen e praktikës profesionale | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Kushtet në laboratorët e TIK-ut | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Furnizimi me materialet mësimore | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 20 | Si bëhet shfrytëzimi i të hyrave vetanake nga ofrimi i arsimit për të rritur, çfarë duhet të ndryshoj në ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur? | | | | | |
| | | | | | | |

<table>
<tr><td rowspan="4">21</td><td rowspan="4">Para pranimit për pjesëmarrje në kurset afatshkurtra (modulare) të arsimit për të rritur, çfarë mund t’u ofronte institucioni juaj kandidatëve të interesuar:</td><td>seanca këshillimi nga zyra për këshillim dhe orientim në karrierë</td></tr>
<tr><td>test për vlerësimin e njohurive</td></tr>
<tr><td>njohjen e mësimit paraprak</td></tr>
<tr><td>asnjërën nga ato më sipër (do t’iu ofronte regjistrim direkt në kurs)</td></tr>
<tr><td rowspan="2">22</td><td colspan="2">Për pranimin e kandidatëve në kurset afatshkurtra (modulare), cilat kritere të pranimit duhet të ndryshojnë në raport me regjistrimin aktual të kandidatëve në arsimin për të rritur</td></tr>
<tr><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td rowspan="2">23</td><td colspan="2">Cilat janë përfitimet e kandidatëve nga ofrimi i programeve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, në kuadër të institucionit tuaj arsimor pasi që siç dihet këto kurse janë të kërkuara nga kandidatët.</td></tr>
<tr><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td rowspan="2">24</td><td colspan="2">Sipas jush, a është e nevojshme përfshirja e instruktorëve të kompanive që bashkëpunojnë me shkollën në procesin e vlerësimit të kandidatëve kur e përfundojnë kursin afatshkurtër (modulare) në arsimin për të rritur</td></tr>
<tr><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td rowspan="2">25</td><td colspan="2">Adresoni sfidat me të cilat mendoni se do të përballej institucioni juaj në rastin e zbatimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur</td></tr>
<tr><td colspan="2"></td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 | Si do t'i vlerësonit elementët e mëposhtëm këshillues dhe udhëzues në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në institucionin tuaj? | | | | | |
| | | Shumë të dobëta | | mira | | Shumë të |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | Këshilla dhe udhëzime profesionale të ofruara nga stafi mësimdhënësit | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Diskutime (konsultime) të provimeve me shkrim, detyrave, vlerësimeve praktike, etj. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | Këshilla profesionale individuale në fush-ën e kursit të ofruar | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 27 | Rekomando masat që duhet të merren për lansimin e suksesshëm të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, në kuadër të institucionit tuaj | | | | | |
| | | | | | | |
| 28 | Specifiko kriteret e vlerësimit dhe monitorimit në zbatimin aktual të arsimit për të rritur, shpjego se si do të përdoreshin këto kritere të vlerësimit në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur | | | | | |
| | | | | | | |

***Tabela 1: Pyetësori***

# 6. ANALIZA E PËRGJIGJEVE NË PYETJET E PYETËSORIT

Në vijim janë prezantuar përgjigjet e të gjitha pyetjeve të parashtruara në pyetësor.

## 6.1. Nevojat për rregullimin e bazës ligjore për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare)

Në përgjigje të pyetjes së parë të pyetësorit, se cilat janë nevojat për rregullimin e bazës ligjore për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në institucionin përkatës, në bazë të përvojës në ofrimin e arsimit për të rritur, përfaqësuesit e shkollave thonë se duhet të rregullohet baza ligjore, duke propozuar që të shkurtohen procedurat e procesit të akreditimit. Nga të njëjtit kërkohet që organizimi në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur të jetë unik për të gjitha shkollat në Kosovë. Sipas tyre, ky proces duhet të jetë i paraparë në kuadër të një kurrikule bërthamë për AARr, të hartohet UA (i ri) e nevojshme, të përcaktohen kualifikimet e kandidatëve, të rregullohet dokumentacioni pedagogjik, certifikatat, si dhe një rregullore (përcaktimi i kostos së trajnimeve, shpërndarja dhe shfrytëzimi i të hyrave) e harmonizuar për të gjithë ofruesit e AAP-së.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *“Sa i përket bazës ligjore, mendoj se duhet të propozuar që të shkurtohen procedurat tejet burokratike të procesit të akreditimit”;*
- *“Është emergjente rregullimi i bazës ligjore në mënyrë që kandidatët që ndjekin këtë mësim të përfitojnë njohuri të mjaftueshme dhe të marrin diploma që njihen në tregun ndërkombëtar”;*
- *“Të nxirret Udhëzimi Administrativ që përcaktohet qartë cilat kategori shoqërore lirohen nga participimi”;*
- *“Plotësimi i bazës ligjore më të detajuar, ka paqartësi duke u bazuar në diskutimet me shkollat tjera. Organizimi i kurseve afatshkurtra (modulare) duhet të jetë unike për të gjithë me përjashtim të kurseve specifike”;*
- *“Nevoja për rregullimin e bazës ligjore për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) është formimi i një kurrikule bërthamë për AARr, që të rregullohen të gjitha dokumentet për AARr”;*
- *“Të hartohen Udhëzimet administrative për rregullimin e mbajtjes së kurseve afatshkurtra; Kualifikimet e kandidatëve; Dokumentacionin pedagogjik; Certifikatat”;*
- *“Duhet të punohet urgjentisht një UA i ri vetëm për arsimin e të rriturve dhe kurseve afatshkurta (modulare). Komform këtij UA duhet të hartohet një rregullore e njëjtë për të gjithë*

*ofruesit e AAP. Kjo rregullore do t'i bënte të pavlefshme rregulloret të cilat varësisht prej komunave ndryshojnë në mes veti";*

- *"Të harmonizohet-rishikohet rregullorja për pagesën – çmimoren e ofrimit të mësimit për të rritur, formula e pagesës së mësimdhënësve, etj.";*
- *"Duhet hartohen udhëzimet tjera për kurset afatshkurtra";*
- *"Deri më tani kurse afatshkurtra ne nuk kemi ofruar, baza ligjore ekziston, por duhet të rregullohen, çështjet si: kostoja e trajnimit, shpërndarja dhe shfrytëzimi i të hyrave, certifikata dhe vlerësimi përfundimtar për kandidatët";*
- *"Caktimi i çmimit të arsimit për të rritur duhet të rishikohet sepse ne gjatë implementimit kishim para vetes taksat për ARr të komunës dhe çmimoren e MAShT-it".*

## 6.2. Aktet ligjore dhe nënligjore për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare)

Lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë (përmirësojnë) arsimin për të rritur, nëse duhet nxjerrë apo rishikuar ndonjë prej tyre për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare), përfaqësuesit e shkollave kanë deklaruar se kërkojnë hartimin e një legjislacioni të ri për këtë çështje, duke përmendur udhëzimin administrativ dhe rregulloren e veçantë në lidhje me ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur. Përmendet gjithashtu edhe nevoja e ofrimit të trajnimeve për mësimdhënësit.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Mendoj se duhet të hartohet një udhëzim i veçantë administrativ, i cili do të përcaktonte qartë të gjitha dispozitat për organizimin e këtij procesi";*
- *"Ne mendojmë se duhet të ngritët një komision kompetent për hartimin apo plotësimin e këtyre akteve ligjore dhe nënligjore";*
- *"Rregullorja për të hyrat dhe shpenzimet duhet të rishikohet";*
- *"Të rishikohen";*
- *"I rritur - çdo person që i ka mbushur pesëmbëdhjetë (15) vjet duhet me ndryshu mosha në 18 vjet e tutje";*
- *"UA11/2014; UA 13/2014; Rregullorja për të hyrat vetanake";*
- *"Vlen përgjigja e pyetjes së parë";*
- *"Shih UA që rregullojnë fushën për ofrimin e arsimit për të rritur";*
- *"Po";*

- *"Me akte ligjore apo rregullore duhet të gjitha çështjet që u cekën në pikën më lartë të rregullohen";*
- *"Mendoj se duhet rregullar çështja e trajnimeve ku çdo mësimdhënës që ofron këtë arsim të i ndjek trajnimet që organizohen të rregullta".*

## 6.3. Baza ligjore për rekrutimin e mësimdhënësve dhe instruktorëve për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr

Gjysma e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK (50%) mendojnë se baza ligjore sa i përket rekrutimit të mësimdhënësve dhe instruktorëve për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur është e mjaftueshme. Sipas tyre, mund të përdoret e njëjta bazë ligjore dhe të plotësohet me ndryshimet e nevojshme. Për më tepër, shih figurën 1.




***Figura 1: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 3 të pyetësorit***

## 6.4. Kapacitetet profesionale, infrastrukturore dhe financiare për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare)

Në pyetjen "Sipas opinionit tuaj, çfarë duhet të ndryshoj apo plotësohet nga formati aktual i ofrimit të arsimit për të rritur, në mënyrë që ky model të ofrohet edhe te kurset afatshkurtra (modulare). Specifiko përmbushjen e kapaciteteve profesionale, kapacitete infrastrukturore dhe financiare?", nga përfaqësuesit e shkollave propozohet që nga shkollat profesionale dhe QK, përveç trajnerëve që duhet pasur, shkollat të kenë mundësinë e vetë-menaxhimit të financave përmes xhirollogarisë së veçantë, ku përveç trajnimeve njëkohësisht të mund të ofrohen shërbime tjera sikurse montimi apo edhe prodhimi, duke llogaritur në sigurimin e materialeve shpenzuese për kryerjen e praktikave profesionale. Është përmendur edhe përmbushja e kritereve të caktuara me qëllim të ofrimit të një arsimi dhe aftësimi cilësor në rastin ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, sikurse ngritja e shkathtësive dhe kompetencave nga ana e mësimdhënësve dhe instruktorëve, pastaj vlerësimi dhe pranimi i njohurive dhe shkathtësive paraprake, posedimi i kabineteve dhe hapësirave të nevojshme për mësim teorik dhe praktikë profesionale. Njëra nga shkollat ka konstatuar se ka kapacitetet e nevojshme dhe janë të gatshëm të fillojnë me ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Kapacitetet profesionale duhet të ofrohen nga qendra që ofron trajnimin (instruktorë, mësimdhënës të licencuar dhe me profil adekuat). Qendra duhet të jetë e pajisur me mjetet e konkretizimit për secilin profil me të cilin konkurron së bashku me materialin shpenzues. Sa i përket financave mendoj se qendra patjetër duhet ta ketë xhirollogarinë e posaçme ku do të grumbulloheshin të gjitha mjetet financiare (që përveç trajnimeve afatshkurtra mund të realizoj edhe punë tjera, si në prodhim, montim apo shërbime)";*
- *"Gjetjen e mënyrave që të zhvillohet mësimi për të gjithë kandidatët pavarësisht numrit nëpër drejtime të regjistruara dhe kandidati që nuk ndjek mësim t'i mohohet e drejta për hyrje në provime";*
- *"Trajnime, përmirësim i kushteve nëpër kabinete, furnizimi me material shpenzues";*
- *"Të caktohen modulet, të caktohet fondi i orëve për secilin modul, duhen të përgatiten modelet e certifikatave për secilin modul, të caktohet kompetenca e cila fitohet si rezultat i aftësimit modular. Ne kemi një model të certifikatave modulare të cilat i kemi harmonizu më herët me Ministrinë e Arsimit";*
- *"Mungesa e kapaciteteve infrastrukturore, mjeteve shkollore, mjeteve financiare*

*vetaneke";*

- *"Mungesa e infrastrukturës shkollore";*
- *"Kurset duhet të jenë të orientuara ne kualifikime të ngushta profesionale p.sh. Saldues, Instalues elektrik, Rrobaqepës, Murator etj.";*
- *"Për të ofruar arsim dhe aftësim cilësor, ofruesit e AAP duhet ti plotësojnë disa nga shumë kritere të kërkuara: Mësimdhënës dhe instruktorë me shkathtësi dhe kompetenca; Hartim dokumentesh për verifikim, vlerësim dhe pranim të njohurive dhe shkathtësive paraprake; Kabinete dhe hapësira të nevojshme për mësim teorik dhe praktikë profesionale; Të llogaritet saktësisht pagesa që bëjnë kandidatët, e cila dihet ti mbulon shpenzimet e materialit shpenzues për praktikë profesionale, taksa administrative, punën e mësimdhënësve dhe instruktorëve, etj.";*
- *"Së pari me çmimet e përcaktuara për një vit shkollor nuk janë të mjaftueshme për të pasur një trajnim të suksesshëm, e njëjta do ishte edhe për trajnime afatshkurta, burokracia në shpërndarjen e mjeteve të grumbulluara-pagesat për mësimdhënësit -trajnerët, furnizimi me materialet e nevojshme e të ngjashme";*
- *"Me akte ligjore apo rregullore duhet të gjitha çështjet që u cekën në pikën më lartë të rregullohen";*
- *"Ne i përmbushim dy format si komplet ofrimin e programit po ashtu edhe atë modular sepse kemi kapacitet e duhura".*

## 6.5. Rregullorja për rregullimin e të hyrave vetanake

25% e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK mendojnë se Rregullorja për rregullimin e të hyrave vetanake nuk i përgjigjet aspak nevojave për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, përderisa 17% mendojnë se i përgjigjet pak. Kurse, pjesa më e madhe, 58% mendojnë se rregullorja e lartpërmendur i përgjigjet aspak nevojave për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur. Për më tepër, shih figurën 2.




*Figura 2: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 5 të pyetësorit*

## 6.6. Nevoja për ndryshime të dokumentacionit pedagogjik

Përfaqësuesit e shkollave ndajnë mendime të ndryshme lidhur me pyetjen: "Në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, a duhet të pësojë ndryshime plotësimi i dokumentacionit pedagogjik, /Po, Jo/. Nëse po, përmendni ndryshimet që ju i mendoni?". Disa prej tyre mendojnë se dokumentacioni pedagogjik duhet të pësojë ndryshime, përmendin ditarët e klasës (ka nga ata që përmendin ditarët modular), librin amë, certifikatat (përmenden certifikata modulare), pastaj përmenden edhe niveli i kalueshmërisë dhe vlerësimi.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Në rend të parë duhet ndryshuar ditari i klasës, libri amë dhe duhet të prodhohet një dokument - certifikatë unike për gjithë Kosovën, në të cilën mbetet hapësira për të shënuar specifikat e secilës qendër";*
- *"Ne mendojmë se dokumentacioni pedagogjik nuk ka nevojë të pësoj ndryshime";*
- *"JO";*

- *"Ditarët modular, certifikatat modulare";*
- *"Jo";*
- *"Mendoj se duhet të ndryshohet duke filluar prej ditarëve të klasave, dëftesat, diploma, certifikata e matur";*
- *"Po - duhet te krijohet një formë e veçantë e dokumentacionit, arsyeja sepse kurset afatshkurta kanë specifika tjera ne krahasim me AAP të rregullt, prandaj dokumentacioni nuk duhet te jetë i njëjtë";*
- *"Po";*
- *"Jo";*
- *"Po/ vlerësimi, dokumentacioni pedagogjik";*
- *"Sipas gjendjes ekzistuese ofrimi i arsimit për të rritur sipas kërkesave të kandidatëve qoftë edhe me një modul (duhet) lejohet, plani për trajnim që hartohet nga shkolla dhe bizneset duhet të jetë funksional dhe të kalojë nëpër kontrolle (filtra) adekuate, të respektohen kriteret e AKK-së, % e praktikës, kalueshmëria, vlerësimi përfundimtarë, të tjera që tani nuk i dimë, etj.";*
- *"Nuk mendoj të ndryshohet sepse ende barasvlefshmëria e arsimit formal dhe jo formal është e njëjtë".*

## 6.7. Rrethanat lehtësuese që do të mundësonin ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr në institucionin përkatës

Përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK kanë listuar disa nga rrethanat lehtësuese që do të mundësonin ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në institucionet e tyre, ndër të cilat janë: organizimi i mësimit gjatë fundjavës, infrastruktura e domosdoshme për disa profile arsimore, përvoja disa vjeçare në ofrimin e arsimit dhe aftësimit profesional për të rritur, staf të kualifikuar dhe me përvojë, infrastrukturë solide për zhvillimin e kurseve, dy programe të gatshme të hartuara nga njëra nga shkollat, përvoja nga platforma online që kanë me ARr, etj.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Ndërlidhja me odat ekonomike, shoqatat zejtare në mënyrë që të kemi njohuri për nevojat më të sakta të tregut të punës për profile";*
- *"Organizimi i mësimit gjatë fundjavës, në mënyrë që kandidatet të vazhdojnë mësimin pa shkëputje nga puna";*
- *"Posedojmë infrastrukturën e domosdoshme për drejtimet: Bujqësi, ekonomi, makineri";*
- *"Trajnime të stafit rreth kurseve afatshkurtra (modulare)";*

- *“Kualifikimi i mësimdhënësve, trajnimi i tyre për kurset afatshkurtra (modulare)”;*
- *“Përvoja disavjeçare me Arsimin dhe Aftësimin Profesional për të Rritur; Kuadër të kualifikuar dhe me përvojë në AAP; infrastrukturë solide për zhvillimin e kursit”;*
- *“Lexoni përgjigjen nr.27”;*
- *“Infrastruktura, stafi i trajnuar”;*
- *“Shkolla jonë ka kushte dhe infrastrukturë për të filluar ofrimin e kurseve, staf mësimorë për disa profile, trajnime, kemi hartuar dy programe që janë të gatshme për të filluar shumë shpejt që na kanë ndihmuar për të kuptuar mënyrën se si mund të realizohet ky proces”;*
- *“Kurrikulat e përditësuara, standardet e profesionit, përvoja nga platforma online që kishim me ARr mund t’i konsideroj si rrethana lehtësuese”.*

## 6.8. Gatishmëria e institucioneve përkatëse për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr

25% e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK thonë se institucioni i tyre është shumë i gatshëm për fillimin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr, përderisa 50% mendojnë se janë të gatshëm deri diku. Për më tepër, shih figurën 3.




***Figura 3: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 8 të pyetësorit***

## 6.9. Profesionet më të kërkuara në tregun e punës

Varësisht nga profilet arsimore që shkollat profesionale dhe Qendrat e Kompetencës ofrojnë, përfaqësuesit e tyre kanë përmendur profilet që sipas tyre janë më të kërkuara në rajonin ku veprojnë institucionet e tyre.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Profilet më të kërkuara janë: Metalpunues, Instalues i ujësjellësit dhe ngrohjes klimatizimit, Automekanik";*
- *"Hoteleri-turizëm, Teknologji-ushqimore, Agrobiznes";*
- *"Ndërtimtari, Informatikë, Instalues Elektrik, Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizim";*
- *"Bujqësi, Instalues të ( ngrohjes, ujit ), Makineri";*
- *"Kontabilitet, Tregti. Asistent hotelier";*
- *"Informatikë, Energjetikë, Instalues i ngrohjes, Operator i prodhimit, Automekanik, Instalues Elektrik";*
- *"Makineri (Saldues, Operator prodhimi, Makina CNC); Elektroteknikë-Instalues elektrik; Ndërtimtari- (Murator, Fasader); Tekstil (Rrobaqepës)";*
- *"Murator-Fasader, Elektricist, Aotoelektricist, Riparues i pajisjeve elektroshtëpiake, etj.";*
- *"Instalues elektrik, Instalues i ngrohjes, Hoteleri dhe turizëm, Kontabilitet, për më tepër duhet të hulumtohet tregu";*
- *"Kuzhinier, ndërtimtar, përpunues i ushqimit dhe rrobaqepës";*
- *"1. Murator dhe punëtorë të ngjashëm, 2. Instalues elektrik, 3 konstruksione të thata*
- *"Nënpunës marketingu, Tik. Murator".*

Për më tepër, shih figurën 4.




| | Metalpunues | Instalues i ujësjellësit dhe ngrohjes klimatizimit | Automekanik | Hoteleri-turizëm | Teknologji-ushqimore | Agrobiznes | Ndërtimtari | Ndërtimtari- (Murator,Fasader) | Ndërtimtari- (konstruksione të thata) | Informatikë | Instalues Elektrik | Bujqesi | Makineri |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 1 | 5 | 2 | 2 | 1 | 1 | 2 | 4 | 1 | 3 | 6 | 1 | 1 |

| | Kontabilitet | Tregti | Asistent hotelier | Energjetikë | Operator I prodhimit | Saldues | Makina CNC | Rrobaqepës | Aotoelektricist | Riparues i pajisjeve elektroshtëpiake | kuzhinier | perpunues i ushqimit | Nepnunes marketingu |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 2 | 1 | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |

*Figura 4: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 9 të pyetësorit*

## 6.10. Çfarë ofrojnë institucionet përkatëse për zbatimin e rregullt të programeve të kurseve afatshkurtra (modulare) në rast të kërkesës?

Duke u përgjigjur në pyetjen "Nëse themi që ka kërkesa nga kandidatët dhe kompanitë për kurset modulare në arsimin për të rritur, çfarë ofron institucioni juaj për zbatimin e rregullt të programeve të kurseve afatshkurtra (modulare)?", përfaqësuesit e shkollave zotohen se kanë kushte infrastrukturore (hapësira të mjaftueshme, kabinete ekzistuese) dhe ekspertizë profesionale nga ekspertët e brendshëm, përkatësisht resurse humane, kuadër profesional e bashkëpunim me biznese.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Ofron kushtet infrastrukturore dhe ekspertizën profesionale nga ekspertët e brendshëm":*
- *"Ofrojmë realizimin e mësimit teorik si dhe shfrytëzimin e kabineteve dhe punëtorive për zhvillim të praktikave profesionale":*
- *"Shkolla jonë organizon rregullisht kurse të Arsimit për të Rritur sipas legjislacionit në fuqi":*
- *"Infrastrukturën , resurset humane":*
- *"Kuadrin e përshtatshëm sipas programeve-kontabilitet":*
- *"Mësimi organizohet në orare të ndryshme nga ofrimi i mësimit të rregullt":*
- *"Ofron kuadrin profesional":*
- *"Hapësirat e institucionit, Kabinetet ekzistuese":*
- *"Për disa profile institucion ynë ka kushte solide dhe për disa të tjera ka kushte të pranueshme":*
- *"Hapësirën e nevojshme dhe të gjitha mjetet e punës sipas profilit të kërkuar. Kabinet me mjete dhe materiale pune, internet, kompjuter, projektor, etj. ":*
- *"Ofron përgatitjen për pjesën e përgjithshme si dhe përgatitjen e moduleve praktike duke u kombinuar me biznesin":*
- *"Kjo pyetje ka përgjigje në pyetjet me lartë":*
- *"Nuk kemi kërkesa te tilla".*

## 6.11. Aspektet e mësimdhënies dhe të nxënit

Përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK janë pyetur lidhur me faktin se sa janë të theksuara në institucionet e tyre aspektet e mëposhtme të mësimdhënies dhe të nxënit: puna në grupe; mësimi në distancë; ligjëratat; praktika profesionale; mësimi me projekte ose të nxënit e orientuar në zgjidhjen e problemeve; mbajtja e shënimeve; prezantimet e kandidatëve; aktivitetet vetë-studim; vlerësimi i kursit nga ana e kandidatëve; komunikimi i respektueshëm ndërmjet mësimdhënësit dhe kandidatit. Përgjigjet e tyre janë si në figurat në vijim.




*Figura 5: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket punës në grupe*




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4 | 2 | 5 | 1 | 0 |

*Figura 6: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket mësimit në distancë*




*Figura 7: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket ligjëratave*




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 0 | 0 | 3 | 5 | 3 |

*Figura 8: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket praktikës profesionale*




*Figura 9: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket mësimit me projekte ose të nxënit e orientuar në zgjidhjen e problemeve*




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 1 | 1 | 3 | 2 | 4 |

*Figura 10: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket mbajtjes së shënimeve*




*Figura 11: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket prezantimeve të kandidatëve*




*Figura 12: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket aktiviteteve vetë-studim*




*Figura 13: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket vlerësimit të kursit nga ana e kandidatëve*




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 0 | 1 | 5 | 6 |

*Figura 14: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 11 të pyetësorit, sa i përket komunikimit të respektueshëm ndërmjet mësimdhënësit dhe kandidatit*

## 6.12. Nevojat për ngritjen e bashkëpunimit publiko-privat për kryerjen e praktikës profesionale, gjatë implementimit të kurseve afatshkurtra (modulare)

Sa i përket nevojave për ngritjen e bashkëpunimit publiko-privat për kryerjen e praktikës profesionale, gjatë implementimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, në kuadër të institucioneve përkatëse arsimore, disa nga përgjigjet kanë qenë: Rregullimi i legjislacionit nga i cili do të përfitonte edhe biznesi i cili sistemon kandidatët për MVP; bashkëpunimi i ngushtë shkollë-biznes, stimulimi (pagesa) për kandidatët; kontratat në mes të shkollës dhe kompanive private të përforcohen dhe mbështeten nga komuna dhe qeveria ne aspektin financiar duke iu ofruar lehtësime tatimore për

kompanitë të cilat bashkëpunojnë me shkolla, etj.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Rregullimi i legjislacionit nga i cili do të përfitonte edhe biznesi i cili sistemon kandidatët për MVP, bashkëpunimi i ngushtë shkollë-biznes, stimulimi (pagesa) për kandidatët";*
- *"Mësimi në vendin e punës dhe realizimi i praktikës profesionale";*
- *"Kontrata në mes të shkollës dhe kompanive private të përforcohen dhe mbështeten nga komuna dhe qeveria ne aspektin financiar duke iu ofruar lehtësime tatimore për kompanitë të cilat bashkëpunojnë me shkolla";*
- *"Marrëveshjet reciproke, dinamika, prioritetet";*
- *"Interesi i kompanisë, nevoja për informata rreth organizimit të kurseve për PP";*
- *"Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe MVP";*
- *"Shembujt dhe aktivitetet/detyrat mësimore që përdoren me nxënësit të jenë të përshtatshme dhe reale; Përvojë motivuese duke mësuar rreth bizneseve/punëdhënësve lokalë dhe duke u angazhuar me ta; garantimi se po u mësojnë diçka vërtet me vlerë nxënësve";*
- *"Së pari baza ligjore";*
- *"Shkolla e ka të pamundur të ketë të gjitha pajisjet për të realizuar praktikën në të gjitha modulet. Për këtë na duhet bashkëpunimi me të gjitha institucionet publike dhe private";*
- *"Komunikim i respektueshëm ndërmjet mësimdhënësit dhe kandidatit";*
- *"1. angazhimi i bashkëpunëtorëve profesional, 2. realizimi i një pjese të praktikës në punën reale në biznese, 3. shfrytëzimi i pajisjeve - makinerive, ka edhe tjera qe tani nuk i dimë";*
- *"Marrëveshjet me biznese, Përshtatshmëria e kërkesës me ofertën".*

### 6.13. Përfitimet e kompanive gjatë bashkëpunimit në zbatimin e programeve afatshkurtra (modulare) të ARr

Sipas përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK, në kuadër të përfitimeve të kompanive gjatë bashkëpunimit në zbatimin e programeve afatshkurtra (modulare) të arsimit për të rritur, në kuadër të institucioneve të tyre arsimore, hyjnë rritja e numrit të kandidatëve potencial të aftësuar për t'u angazhuar nëpër kompani të ndryshme, përkatësisht punonjës të rinj apo mundësi që kompanitë të rekrutojnë staf profesional dhe të kualifikuar, rritje të prodhimit dhe shërbimeve cilësore.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Rritja e numrit të kandidatëve të aftësuar për kompanitë. Harmonizimi i planeve dhe dinamika e punës së përbashkët duke nda detyrat dhe përgjegjësitë";*
- *"Plotësimi i nevojave të tregut-kompanisë me kuadro të nevojshme, ofrimi i informatave për formën dhe mënyrën e organizimit të programeve";*
- *"Aftësimi i kandidatëve në praktikën profesionale në kompani";*
- *"Për t'ia prezantuar kompaninë/sektorin e tyre një force punonjëse";*
- *"Potenciale të ardhshme";*
- *"Për t'u angazhuar me aplikantët e mundshëm për stazh pune/"punonjës të rinj";*
- *"Për të rritur partneritetet me shkollat";*
- *"Mundësitë për kompanitë për rekrutim të stafit profesional dhe të kualifikuar; Rritje të prodhimit dhe shërbimeve cilësore, etj.";*
- *"Për t'ia prezantuar kompaninë/sektorin e tyre një force punonjëse";*
- *"Potenciale të ardhshme";*
- *"Për t'u angazhuar me aplikantët e mundshëm për stazh pune/punonjës të rinj";*
- *"Për të rritur partneritetet me shkollat";*
- *"Kyçja e komunës dhe institucionet tjera publike";*
- *"Kompanitë në ketë rast kanë përfitime në lidhje me kualifikimin e punëtorëve sipas nevojave, ngritjen e kapaciteteve, përvoja të reja se bashku me shkollat në lidhje me organizimin e programeve mësimore";*
- *"Nuk kemi përvoja të tilla, jemi IAAP që vetëm një gjeneratë e ka ofruar të ARr".*

### 6.14. Trajnimet e nevojshme për stafin e angazhuar në kurset afatshkurtra (modulare) në ARr

Duke listuar trajnimet e nevojshme (Andragogjike, metodike-didaktike apo profesionale) për stafin e angazhuar në kurset afatshkurtra (modulare) në ARr në kuadër të institucioneve të tyre arsimore, përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK përmendin nevojën për trajnime të vazhdueshme si në andragogji dhe metodikë dhe didaktikë, si dhe trajnime profesionale, me qëllim të avancimit në hap me kohën dhe në hap me ndryshimet teknologjike në profesion. Nga të njëjtit përmenden gjithashtu trajnime specifike profesionale në përdorimin e metodave dhe teknologjive të reja të pajisjeve dhe makinerive, sikurse trajnimet për programim në makinat CNC, mësimdhënia online, trajnime për metodologjinë e vlerësimit, si dhe trajnime për komunikim me masën.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *“Stafi i institucionit tonë mund të ketë nevojë për ndonjë trajnim në fushën e Andragogjisë, kurse ato të metodike-didaktike i kanë të përfunduar”;*
- *“Andragogjike dhe metodike-didaktike”;*
- *“Trajnime shtesë janë të nevojshme”;*
- *“Edhe pse ekziston stafi i trajnuar në shumë fusha profesionale, gjithmonë kërkohet avancimi në kohë dhe perspektivë e teknologji në profesion”;*
- *“Trajnime profesionale”;*
- *“Trajnimet: Andragogjike, metodike-didaktike apo profesionale janë të nevojshme”;*
- *“Programimi në Makinat CNC; Mësimdhënia Online”;*
- *“Trajnim të mësimdhënësve dhe i instruktorëve në metodologjinë e mësimdhënies dhe instruktimit; Trajnim adekuat dhe të akredituar për andragogji; Trajnim për metodologjitë e vlerësimit, etj.”;*
- *“Metodik didaktike profesionale për të rritur, kur ke parasysh faktin se mësimdhënësit punojnë me nxënës të moshës adoleshente, duhet të marrin disa trajnime ku trajnohen që të punojnë me të rritur, ndërrohet qasja e mësimdhënies”;*
- *“Komunikimi me masën, metodike -didaktike për kurse të shkurtra”;*
- *“Përveç pjesës pedagogjike mësimdhënësit duhet të jenë të pajisur me kompetenca profesionale për fusha të caktuara, hartimin e listave në lidhje me organizimin e mësimit për këta kandidatë, trajnime në përdorimin e metodave dhe teknologjive të reja të pajisjeve dhe makinerive”;*
- *“Metodik didaktik, Didaktik profesionale”.*

## 6.15. Ofrimi i trajnimeve shtesë për mësimdhënësit

Në përgjigjet e marra nga pyetja e pesëmbëdhjetë “Sipas opinionit tuaj, sa do ta pranonin mësimdhënësit ofrimin e trajnimeve shtesë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale, në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur?”, 16% e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK ndajnë mendimin se mësimdhënësit do ta pranonin ofrimin e trajnimeve shtesë në nivelin “mesatar”, 42% ndajnë mendimin se mësimdhënësit do ta pranonin ofrimin e trajnimeve shtesë në një nivel “të mirë” dhe po aq prej tyre ndajnë mendimin se mësimdhënësit do ta pranonin “shumë” ofrimin e trajnimeve shtesë. Për më tepër, shih figurën 15.




*Figura 15: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 15 të pyetësorit*

## 6.16. Format e organizimit të mësimit me rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr

Përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK i japin përparësi organizimit të mësimit në orar të ndryshëm nga ofrimi i mësimit të rregullt në shkollë, apo organizimit të mësimit për ofrimin e kurseve afatshkurtra vetëm gjatë fundjavave. Për më tepër, shih figurën 16.




*Figura 16: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 16 të pyetësorit*

## 6.17. Përparësitë e formës së organizimit të mësimit me rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr

Bazuar në zgjedhjet e mësipërme, përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK përmendin përparësitë e alternativës së përzgjedhur, në lidhje me mënyrën e organizimin të mësimit që do t'u ofrohej kandidatëve në institucionet e tyre. Ndër të tjera, për mësimin në fundjavë, ata thonë se është më i përshtatshëm për shkak se kandidatët e ARr shumica janë të punësuar dhe nuk kanë mundësi të vijimit të kurseve gjatë ditëve të punës.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Meqenëse pjesa më e madhe e kandidatëve llogaritet se janë në marrëdhënie pune, poashtu edhe nxënësit nuk janë në proces mësimor, mësimdhënësi - instruktori janë më të lirë nga aktivitetet tjera, atëherë këto mund të ishin disa nga arsyet kryesore";*
- *"Përparësia është pa shkëputje nga puna";*
- *"Mësimi në fundjavë është më i përshtatshëm për shkak që kandidatët e arsimit për të rritur shumica janë të punësuar dhe nuk kanë mundësi të vijimit të kurseve gjatë javës";*
- *"Respektimi i nevojave kohore për vijuesit me qellim të shfrytëzimit maksimal të kohës në aftësim dhe obligimeve tjera të cilat kanë pjesëmarrësit dhe mësimdhënësit";*
- *"Shprehja e gatishmërisë së tyre, për ballafaqimin me realitetin e mësimit të rregullt, inkorporimi dhe ndonjë formë bashkëpunimi";*
- *"Mësimi të organizohet në orar të ndryshme nga ofrimi I mësimit të rregullt";*
- *"Mësimi i tillë nuk do të pengonte mësimin e rregullt - zakonisht mësimi të organizohet pas mësimit të rregullt, fundjava do të ishte e lirë, kursi do të ishte më intensiv";*
- *"Mësimi do te organizohej pasdite, duke marr për bazë kërkesat e kandidatëve";*
- *"Planifikimi më i lehtë, hapësira e mjaftueshme";*
- *"Si propozim që vjen nga shkolla jonë është që mësimi të mbahet pasdite për arsye: mësimdhënësit janë të lirë ketë kohë, hapësirat e shkollës janë të lira, kandidatët e përfundojnë orarin e rregullt të punës, etj.";*
- *"Mësimi do të organizohej vetëm fundjavave, për shkak të angazhimit të kandidatëve në vendet e punës dhe aktiviteteve tjera sociale".*

### 6.18. Kohëzgjatja e përgatitjeve për të filluar më regjistrimin e kandidatëve në kurset afatshkurtra (modulare)

Duke pasur parasysh kapacitetet aktuale teknike dhe profesionale në institucionet e tyre, përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK japin mendime të ndryshme rreth asaj se sa kohë do tu merrnin përgatitjet e duhura për të filluar me regjistrimin e kandidatëve në kurset afatshkurtra (modulare) në ARr. Disa prej tyre thonë 10 ditë e disa 3 muaj.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Sa i përket kapaciteteve teknike dhe profesionale, mendoj se nuk do të na nevojitej më shumë se 10 ditë (përjashto procesin e akreditimit që është temë në vete)";*
- *"1 muaj";*
- *"Dy javë deri në një muaj";*
- *"3 jave deri një muaj";*
- *"Së paku 3 muaj";*
- *"Kandidatëve t'i mundësohet përzgjedhja e alternativave të përmendura më sipër";*
- *"Përafërsisht 1 muaj";*
- *"Për pjesën më madhe të moduleve nga profilet që ka shkolla, ne jemi të gatshëm që tani të fillojmë kurset afatshkurta modulare";*
- *"Përjashto nevojën për akreditim dhe vështirësitë që kemi si institucione publike për tu akredituar, mungesë të mjeteve, kurikulave si dhe llojit të profilit, menjëherë mund të fillojmë qe të organizojmë këto kurse";*
- *"60 ditë";*
- *"Tani në dy programe ne jemi gati, vetëm koha deri në akreditim që është e nevojshme mund të llogaritet";*
- *"Jo aq shumë, vetëm në përzgjedhjen e mësimdhënësve ligjërues, ndarjen e moduleve, emërimin e kujdestarit dhe ndonjë kërkesë eventuale teknike".*

### 6.19. Kushtet teknike dhe profesionale në institucionet përkatëse

Përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK janë pyetur lidhur me kushtet teknike dhe profesionale në institucionet e tyre, duke nisur nga kushtet në klasat e mësimit, kushtet në punëtoritë për organizimin e praktikës profesionale, qasjen e mundshme në internet, mundësitë për konsultim me stafin mësimdhënës,

cilësinë e pajisjeve në punëtoritë për kryerjen e praktikës profesionale, kushtet në laboratorët e TIK-ut dhe furnizimin me materialet mësimore. Përgjigjet e tyre janë si në figurat në vijim.




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 0 | 0 | 1 | 5 | 6 |

***Figura 17: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket kushteve në klasat e mësimit***




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 0 | 1 | 3 | 5 | 3 |

*Figura 18: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket kushteve në punëtoritë për organizimin e praktikës profesionale*




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 0 | 1 | 1 | 7 | 3 |

*Figura 19: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket qasjes së mundshme në internet*




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 0 | 0 | 5 | 7 |

*Figura 20: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket mundësive për konsultim me stafin mësimdhënës*




***Figura 21: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket cilësisë së pajisjeve në punëtoritë për kryerjen e praktikës profesionale***




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 1 | 5 | 3 | 2 |

*Figura 22: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket kushteve në laboratorët e TIK-ut*




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 0 | 2 | 3 | 2 | 2 |

*Figura 23: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 19 të pyetësorit, sa i përket furnizimit me materialet mësimore*

## 6.20. Shfrytëzimi i të hyrave vetanake nga ofrimi i arsimit për të rritur

Përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK përmendin modele të ndryshme të shfrytëzimit të të hyrave vetanake, varësisht nga rregulloret të cilave ju referohen apo komunave ku shkollat veprojnë, duke potencuar nevojën e unifikimit të formulës së shfrytëzimit të të hyrave vetanake nga ofrimi i arsimit për të rritur.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Të hyrat vetanake nga Arsimi i të Rriturve shfrytëzohet për pagesën e stafit*

*mësimdhënës, por nëse realizohen edhe trajnimet afatshkurtra modulare, atëherë një pjesë duhet të shfrytëzohen edhe për materialin e shpenzuar, amortizim të mjeteve themelore dhe komunali";*

- *"Sipas UA- në fuqi dhe një rregulloreje të brendshme të shkollës bazuar në UA. Do të ishte shumë e mirëseardhur të bëhej një rregullore për shpërndarje e të hyrave vetanake në nivel të Republikës";*
- *"Shkolla i shfrytëzon vetëm 70% të hyrave vetanak për pagesën e stafit të angazhuar kurse 30% mbesin në buxhetin e DKA-së";*
- *"Posedojmë një propozim rregullore shumë të arsyeshme";*
- *"Kompensimi i stafit dhe pjesa tjetër bartet në buxhetin komunal dhe rimbursohet nga buxheti i përgjithshëm";*
- *"Shfrytëzimi i të hyrave vetanake nga ofrimi i arsimit për të rritur bëhet sipas një rregulloreje";*
- *"Në bazë të Rregullores për të Hyrat vetanake 40% shpërndahen për Profesorët, 12% për Administratë (Drejtori 4 %, Sekretari 3 %, Koordinatori 3 %, Punëtorët tekniko shërbyes 3 %), 48% shfrytëzohen për nevoja të shkollës";*
- *"Në bazë të rregullores për të hyrat vetanake të Komunës së Prizrenit";*
- *"Të hyrat vetanake kalojnë ne fondin qeveritar-me unitet të shkollës, me kërkesë shpërndahen 60% për shkollën-me mësimdhënës. Kërkesë që të decentralizohet shkollat dhe aktivitetet për organizimin e kurseve dhe shpërndarja përdorimi i mjeteve të behet me nga vet ajo, kjo mundëson pajisjen me materialet e nevojshme në kohë reale";*
- *"Si bëhet shfrytëzimi i të hyrave vetanake nga ofrimi i arsimit për të rritur, çfarë duhet të ndryshoj në ofrimin e kurseve afatshkurtra modulare në arsimin për të rritur?";*
- *"kostoja e trajnimit të përcaktohet nga Shkolla varësisht prej profilit, dhe ne të, të përfshihen: 1. % në lidhje me shfrytëzimin e hapësirave të Shkollës, 2. energjia elektrike, mjetet e punës, materialet mësimore, materialet për punë praktike, administrata, stafi mësimorë, stafi menaxhues, etj. këto mjete duhet shpërndahen shpejt dhe lehtë për të gjitha pozicionet";*
- *"Duhet të rishikohet ndarja e % sepse në përvojën e parë (kohe pandemie) e kemi shfrytëzuar rregulloren e shkollës teknike 11 Marsi e cila nuk ishte e përshtatshme për shkollën tonë".*

## 6.21. Çfarë mund t’u ofrojnë institucionet përkatëse kandidatëve të interesuar para pranimit për pjesëmarrje në kurse afatshkurtra?

Në përgjigjet e marra nga pyetja e pesëmbëdhjetë “Para pranimit për pjesëmarrje në kurset afatshkurtra (modulare) të arsimit për të rritur, çfarë mund t’u ofronte institucioni juaj kandidatëve të interesuar?”, përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK thonë se në shumicën e rasteve do të jenë seanca këshillimi nga Zyra për këshillim dhe orientim në karrierë. Për më tepër, shih figurën 24.




*Figura 24: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 21 të pyetësorit*

## 6.22. Kriteret e pranimit në kurset afatshkurtra (modulare)

Të pyetur lidhur me pranimin e kandidatëve në kurset afatshkurtra (modulare), se cilat kritere të pranimit duhet të ndryshojnë në raport me regjistrimin aktual të kandidatëve në arsimin për të rritur, përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK ndër të tjera ndajnë mendimin se duhet hequr kriteri i moshës dhe shuma e pagesës. Sipas tyre, kriteret e pranimit duhet të rregullohen me udhëzim të veçantë.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Duhet të hiqet kriteri i moshës dhe shuma e pagesës";*
- *"Asnjë";*
- *"Shpallen programet modulare, në cilat fusha dhe fondi orëve për çdo modul (kemi një model praktik)";*
- *"Nuk kemi pasur kurse të ofruara";*
- *"Si kriter mosha e kandidatëve, të punësuarit";*
- *"Kandidatët duhet të kenë njohuri bazike për kursin që aplikon";*
- *"Dëshmi për mësim paraprak (njohuri, shkathtësi dhe kompetenca)";*
- *"E mirëseardhur-njohuritë paraprake-ushtrimi i profesionit paraprakisht-kërkesë për avancim përmes kurseve që ofrojmë";*
- *"Kriteret të rregullohen me udhëzime të veçanta";*
- *"Tani nuk e di se cilat janë kriteret për regjistrim të kandidatëve për arsimin e të rriturve, por çka propozojmë ne është se për ta ndjekur një modul, 2 apo më shumë module varësisht prej nevojave të tyre e deri te një nivel i kualifikimit, kandidati duhet të jetë në gjendje të mirë fizike, shëndetësore dhe të jetë i motivuar për ta ndjekur një trajnim që i duhet, qoftë edhe një modul";*
- *"Kushtet për regjistrim ne ARr i konsideroj të pranueshme për secilin kandidat".*

## 6.23. Përfitimet e kandidatëve nga ofrimi i programeve afatshkurtra (modulare) në ARr

Sipas të intervistuarve, përfitimet kryesore të kandidatëve nga ofrimi i programeve afatshkurtra (modulare) në ARr në institucionet përkatëse janë përgatitja e kandidatit për tregun e punës si në aspektin profesional ashtu edhe në atë psiko-fizik, aftësimi sipas kërkesave të tregut të punës në fushat specifike dhe me kompetencë reale, fitimi i njohurive të reja, mundësia më e madhe për punësim apo vetëpunësim, arritja e kompetencave të nevojshme, ri profilizimi në afat të shkurtër dhe rikthimi në punë me kompetenca të reja, certifikimi dhe diploma nga një institucion i akredituar.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Përfitimet kryesore janë përgatitja e kandidatit për tregun e punës si në aspektin profesional ashtu edhe në atë psiko-fizik!";*
- *"Pajisja e kandidateve me dokumentacion pedakogjik (dëftesa, certifikata dhe diplomë)";*
- *"Pajisja me Diplomë të njohur ndërkombëtarisht dhe aftësimi për punë në tregun e punës brenda dhe jashtë Kosovës";*
- *"Aftësohen sipas kërkesave të tregut të punës në fushat specifike dhe me kompetencë reale";*
- *"Sigurimi i vendeve të punës pas kualifikimit të fituar, fitimi i njohurive të reja, procesi i inkuadrimit në tregun e punës";*
- *"Aftësimi për profilet arsimore për tregun e punës";*
- *"Kandidatët krijojnë aftësi solide në profesionin e caktuar, mundësia për punësim apo vetëpunësim më e madhe";*
- *"Punësimi, vetëpunësimi etj.";*
- *"Arritja e kompetencave të nevojshme-riprofilizimi në afat të shkurtër dhe rikthimi në punë me kompetenca të reja-kërkuar nga tregu i punës";*
- *"Përgatitja profesionale konform kërkesave të tregut të punës, përgatitja e kandidatit me shkathtësi të buta dhe etikë profesionale";*
- *"Kandidatët ngrisin kapacitetet e tyre profesionale, kontribut më të madh në punë e tyre dhe për njohuritë e fituara pajisen me certifikatë përkatëse";*
- *"Certifikata dhe diploma nga një institucion i akredituar".*

### 6.24. Nevoja për përfshirjen e instruktorëve të kompanive që bashkëpunojnë me shkollën në procesin e vlerësimit të kandidatëve

Përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK deklarojnë se është e nevojshme përfshirja e instruktorëve të kompanive që bashkëpunojnë me shkollën në procesin e vlerësimit të kandidatëve, kur të njëjtit e përfundojnë kursin afatshkurtër (modulare) në ARr.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Po, do të ishte shumë e nevojshme";*

- *"Po";*
- *"Për punën praktike që kryhet në ndërmarrje private është i nevojshëm vlerësimi për njohuritë e fituara nga kandidatët";*
- *"Po, sepse ata duhet te njoftohen me aftësitë reale të kandidateve që certifikohen";*
- *"PO";*
- *"Është e nevojshme përfshirja e instruktorëve të kompanive që bashkëpunojnë me shkollën në procesin";*
- *"Po";*
- *"Po";*
- *"Mendoj se është vlerë e shtuar, por edhe këtu duhet shikuar mënyra e pagesës pasi që ata nuk kanë kohë për te humbur dhe nuk i përgjigjen lehtë kërkesave që ka shkolla";*
- *"Po";*
- *"Po";*
- *"Në profilet që i ofron shkolla jonë mjafton profesori dhe instruktori i shkollës tonë".*

## 6.25. Sfidat me të cilat mund të përballen institucionet përkatëse në rastin e zbatimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr

Të intervistuarit kanë deklaruar se në rastin e zbatimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr, institucionet e tyre arsimore do të përballen me vështirësitë në formimin e grupeve për profile të caktuara si pasojë e kostos, mungesën e përvojës për organizimin e kurseve të tilla, gatishmërinë e kandidatëve për kurse afatshkurtra, mungesën e materialeve shpenzuese, etj.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Sfida kryesore do të ishte përballimi i kostos së pagesës nga ana e kandidatëve, sepse disa profile mund të jenë edhe të kushtueshme, çka do të nënkuptonte edhe vështirësi në formimin e grupit";*
- *"Normalisht se kemi mjaft sfida";*
- *"Po, sepse ata duhet të njoftohen me aftësitë reale të kandidatëve që certifikohen";*
- *"Mungesa e përvojës për organizimin e kurseve të tilla, gatishmëria e kandidatëve për kurse afatshkurtra; Krijimi i bazës materiale (Materialeve harxhuese, Pajisjeve)";*
- *"Bashkëpunimi me ndërmarrjet për realizimin e kursit";*
- *"Përzgjedhja e kursanteve";*
- *"Infrastruktura shkollore";*

- *"Mënyra e pagesës-të kurseve-mësimdhënësve, orari i mësimdhënësve, etj.";*
- *"Vlerësimi i përbashkët me biznesin i kandidatit";*
- *"Shfrytëzimi i të hyrave vetanake, si dhe kushte tjera që janë cekur në pikën 20";*
- *"Nuk besoj se do kemi sfida sepse kurrikulat tona janë të përditësuara viteve të fundit".*

## 6.26. Vlerësimi i elementeve këshilluese dhe udhëzuese në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare)

Përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK janë pyetur se si do t'i vlerësonin disa nga elementet këshilluese dhe udhëzuese në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në institucionet e tyre. Përgjigjet e tyre janë si në figurat në vijim.




| 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|
| 0 | 0 | 1 | 5 | 6 |

***Figura 25: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 26 të pyetësorit, sa i përket këshillave dhe udhëzimeve profesionale të ofruara nga stafi (mësimdhënësit)***




*Figura 26: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 26 të pyetësorit, sa i përket diskutimeve (konsultimeve) të provimeve me shkrim, detyrave, vlerësimeve praktike, etj.*




| | 1-Aspak | 2-Pak | 3-Mesatarisht | 4-Mirë | 5-Shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| ■ | 0 | 0 | 0 | 7 | 5 |

***Figura 27: Përgjigjet e të intervistuarve në pyetjen 26 të pyetësorit, sa i përket këshillave profesionale individuale në fushën e kursit të ofruar***

## 6.27. Masat që duhet të merren për lansimin e suksesshëm të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr

Të intervistuarit thonë se për lansimin e suksesshëm të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, në kuadër të institucionit e tyre arsimore, duhet të bëhen përgatitjet e infrastrukturës teknike e pedagogjike në qendër, të sigurohet kuadri adekuat, të arrihet bashkëpunim i ngushtë me sektorin privat, të bëhet një hulumtim i tregut, të krijohen planet mësimore modulare për ofrim të trajnimit, etj.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Informimi me kohë i akterëve relevant si dhe përgatitjet e infrastrukturës teknike e*

*pedagogjike në qendër";*

- *"Përgatitja e infrastrukturës shkollore dhe sigurimi i kuadrit adekuat";*
- *"Bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat";*
- *"Punë me projekte, detyra, kontrolle, përgjegjësi";*
- *"Organizimi i trajnimeve, këshillave dhe përvojat nga praktikat e shkollave tjera";*
- *"Diskutime (konsultime) të provimeve me shkrim, detyrave, vlerësimeve praktike, etj.";*
- *"Krijimi i kushteve të nevojshme të cilat janë të domosdoshme për kursin";*
- *"Krijimi i partneritetit me kompanitë";*
- *"Përzgjedhja e stafit përkatës";*
- *"Informimi i kandidatëve të mundshëm lidhur me kursin etj.";*
- *"Lehtësime ligjore; Dokumentacion të kapshëm pedagogjik; Autonomi më të madhe për ofruesit e AAAP; Furnizim me pajisje dhe material shpenzues për kabinete, etj.";*
- *"Të bëhet një hulumtim i tregut, të krijohen planet mësimore modulare për ofrim të trajnimit, të harmonizohet rregullorja-UA për mjetet vetanake dhe të lehtësohet mënyra e përdorimit të këtyre të hyrave - për të përmbush më lehtësisht nevojat që kërkojnë kandidatët - të rregullohet mënyra e pagesës për trajnerin-mësimdhënësin";*
- *"Rregullimi i bazës ligjore/ udhëzimet e qarta për çdo hap të realizimit të kurseve afatshkurtra duke eliminuar çdo paqartësi";*
- *"Njoftimi për ndërmarrjet dhe kandidatët e interesuar, shoqatat, zyrën e punësimit, grupet e interesit, akreditimi apo certifikimi nga institucione kredibile kombëtare dhe ndërkombëtare";*
- *"Ndarja e moduleve caktimi fondit të orëve, caktimi i saktë i kredive".*

## 6.28. Kriteret e vlerësimit dhe monitorimit në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në ARr

Të intervistuarit kanë specifikuar kriteret e vlerësimit dhe monitorimit në zbatimin aktual të ARr, duke u fokusuar në përdorimin e të njëjtave në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare). Ndër të tjera, të njëjtit kanë përmendur vlerësimin me gojë, testin me shkrim dhe listën e kontrollit.

Për më tepër, përgjigjet e përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK janë si në vijim:

- *"Kriteret e vlerësimit do të zbatoheshin ato standarde siç janë: vlerësimi me gojë, testi me shkrim dhe lista e kontrollit";*

- *"Kriteret e vlerësimit dhe monitorimit në zbatimin aktual të arsimit për të rritur bëhen sipas UA-për vlerësim";*
- *"Monitorim i vazhdueshëm i punës praktike dhe aspektit të nxënit teorik";*
- *"Hartim i projekteve, rezultati i të mësuarit, zbatimi i projekteve, instrumenti vlerësimit";*
- *"Të përdoren kritere konform kandidatëve, duke marrë për bazë statusin e tyre kurse monitorimi nga menaxhmenti i shkollës dhe personat përgjegjës";*
- *"Diskutime (konsultime) të provimeve me shkrim, detyrave, vlerësimeve praktike, etj. Vlerësimi i praktikës profesionale në Kompani; Vlerësimi sipas UA të MASHT";*
- *"Test; Angazhimi gjatë Kursit, Projekte, Punim praktik";*
- *"Vlerësimi duhet të ndahet ne 3 pjesë: 1. Test teorik i integruar ndër modular, 2. Shkathtësi praktike sipas metodës me projekte ose me poste pune (varësisht nga modulet) 3. Vlerësim kompetencash personale dhe sociale";*
- *"Kriteret e vlerësimit janë të rregulluara me UA ne fuqi, ku parashihet edhe inkuadrimi i instruktorit të jashtëm-kompania";*
- *"Do të përdoreshin kriteret aktuale duke i modifikuar për profilin përkatës";*
- *"Duhet të hartohen instrumente të sakta dhe praktike për vlerësim dhe monitorim të procesit deri në certifikim të kandidatëve";*
- *"Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara në çdo modul sipas RM-ve andaj nuk do të ishte e vështirë të vazhdohej me formën e njëjtë edhe në ofrimin e kurseve modulare".*

# 7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në pyetësor janë vendosur njëzetetetë pyetje për të cilat është kërkuar përgjigje nga përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe QK në vend. Pyetjet në pyetësor janë nga më të ndryshmet, prej atyre të hapura dhe të mbyllura, ku në rastin e pyetjeve të mbyllura është kërkuar të jepen vlerësime me nivele nga një deri në pesë (1-Aspak; 2-Pak; 3-Mesatarisht; 4-Mirë; 5-Shumë), pastaj është kërkuar të bëhen konstatime me "Po" ose "Jo". Kurse, në rastin e pyetjeve të hapura është lënë mundësia për përgjigje të lira në hapësirat e zbrazura, në rastin e secilës pyetje të tillë.

Pyetësori fillon me pjesën e parë (gjashtë pyetjet e para të pyetësorit) ku janë kërkuar përgjigje në lidhje me legjislacionin dhe nevojat për ndryshim, në pjesën e dytë (nga pyetja e shtatë deri në pyetjen e njëzetë) është tentuar të merren informacione në lidhje me kapacitetet teknike dhe profesionale në shkolla dhe QK, përfshirë edhe nevojat për zhvillimin e programeve modulare për të rritur, ndërsa pjesa e tretë (pjesa e fundit në pyetësor) posedon pyetje përmes përgjigjeve të të cilave është tentuar të merren informacione në lidhje me nevojat e pjesëmarrësve, profesionet më të kërkuara në rajonet përkatëse, vlerësimin dhe certifikimin e pjesëmarrësve, përfshirë monitorimin e tyre pas përfundimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur.

Në pyetjet e pyetësorit janë përgjigjur përfaqësuesit e 14 shkollave profesionale nga qytete të ndryshme në Republikën e Kosovës, duke përfshirë Prishtinën, Prizrenin, Mitrovicën, Gjakovën, Gjilanin, Ferizajn, Podujevën, Lipjanin, Vushtrrinë, Skenderajn, Malishevën dhe Vitinë.

Përfaqësuesit e shkollave profesionale të cilët kanë marrë pjesë në punëtorinë e parë të organizuar nga AAAPARr dhe DVV International dhe të cilët kanë dhënë vlerësimet e tyre në lidhje me mundësitë e ofrimit të kurseve afatshkurtra në arsimin për të rritur, kanë pasur mundësinë që të jenë pjesëmarrës dhe të japin komentet dhe përshtypjet e tyre në punëtorinë e dytë ku është prezantuar draft-dokumenti dhe iu është dhënë kohë e mjaftueshme për të kontribuar në prezantimin sa më të saktë të të gjeturave në këtë hulumtim.

Siç është shënuar edhe më sipër, ky hulumtim fokus të veçantë ka pasur analizën dhe hulumtimin e nevojave në terren për të siguruar mundësitë e ofrimit të kurseve afatshkurtra në arsimin për të rritur, në kuadër të shkollave të mesme profesionale dhe Qendrave të Kompetencës në Kosovë. Në takimin e parë të përbashkët të organizuar me drejtuesit e shkollave profesionale dhe QK, pjesëmarrës edhe në plotësimin e pyetësorit, është marrë perceptimi i tyre mbi rëndësinë dhe nevojën e organizimit të mësimit në ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, kurse në fazat e mëvonshme

përmes pyetësorit dhe intervistave të realizuara janë evidentuar gjithashtu mundësitë reale të ofrimit të kurseve afatshkurtra në arsimin për të rritur, nëpër shkollat profesionale dhe QK në vend.

Nga të dhënat e mbledhura përmes përgjigjeve të dhëna në pyetësor nga ana e përfaqësuesve të shkollave, shkollave profesionale dhe QK iu është dhënë mundësia të paraqesin gjendjen reale dhe të tregojnë mundësitë e ofrimit të kurseve afatshkurtra në arsimin për të rritur në varësi të kushteve që shkollat posedojnë. Gjithashtu, përmes pyetësorit shkollat kanë pasur mundësi të shprehin kërkesat e tyre në lidhje me plotësimin e nevojave të tyre në realizim të trajnimeve për mësimdhënësit apo pajisjen e punëtorive për realizimin e praktikave profesionale.

Sigurisht, programet e ndryshme të kurseve afatshkurtra (modulare) gjatë realizimit të tyre do të përfshinin në vete një kosto financiare të caktuar, varësisht nga kohëzgjatja, numri i kandidatëve dhe lloji i profilit arsimor dhe kjo kosto financiare pëson ndryshime të theksuara për shkak të nevojës së realizimit të praktikave profesionale me pajisje (mjete konkretizuese) të kushtueshme në disa profile arsimore specifike.

Nga përgjigjet e dhëna në pyetjet e pyetësorit, përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe të QK kanë dhënë mendimet e tyre në lidhje me përvojën e tyre në rastin ofrimit të arsimit për të rritur, pastaj nevojës për rregullimin e bazës ligjore për ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në institucionet që ata përfaqësojnë, ndryshimet dhe plotësimet që mund të bëhen në rastin e përmirësimit të bazës ligjore aktuale, nëse do të rishikohej legjislacioni për arsimin për të rritur si tërësi me qëllim edhe të përfshirjes së kurseve afatshkurtra (modulare). Kështu, si përfundime dhe rekomandime bazuar në përgjigjet e dhëna në pyetësor janë identifikuar këto të dhëna:

- Kërkohet që organizimi në rastin e ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur të jetë unik për të gjitha shkollat në Kosovë. Sipas përfaqësuesve të shkollave profesionale dhe QK, ky proces duhet të jetë i parapare në kuadër të një kurrikule bërthamë për AARr, të hartohet UA (i ri) e nevojshme, të përcaktohen kualifikimet e kandidatëve, të rregullohet dokumentacioni pedagogjik, certifikatat, pastaj një rregullore (përcaktimi i kostos së trajnimeve, shpërndarja dhe shfrytëzimi i të hyrave) e harmonizuar për të gjithë ofruesit e AAP-së;
- Kërkohet hartimi i një legjislacioni të ri për këtë çështje, duke përmendur udhëzimin administrativ dhe rregulloren e veçantë në lidhje me ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur. Përmendet gjithashtu edhe nevoja e ofrimit të trajnimeve për mësimdhënësit;

- Propozohet që nga shkollat profesionale dhe QK, përveç trajnerëve që duhet t'i ketë shkolla, shkollat të kenë mundësinë e vetë-menaxhimit të financave përmes xhirollogarisë së veçantë, ku përveç trajnimeve njëkohësisht të mund të ofrohen shërbime tjera sikurse montimi apo edhe prodhimi, duke llogaritur në sigurimin e materialeve shpenzuese për kryerjen e praktikave profesionale. Është përmendur edhe përmbushja e kritereve të caktuara me qëllim të ofrimit të një arsimi dhe aftësimi cilësor në rastin ofrimit të kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur, sikurse ngritja e shkathtësive dhe kompetencave nga ana e mësimdhënësve dhe instruktorëve, pastaj vlerësimi dhe pranimi i njohurive dhe shkathtësive paraprake, posedimi i kabineteve dhe hapësirave të nevojshme për mësim teorik dhe praktikë profesionale. Njëra nga shkollat ka konstatuar se ka kapacitetet e nevojshme dhe janë të gatshëm të fillojnë me ofrimin e kurseve afatshkurtra (modulare) në arsimin për të rritur;
- Dokumentacioni pedagogjik duhet të pësojë ndryshime, përmendin ditarët e klasës (ka nga ata që përmendin ditarët modular), librin amë, certifikatat (përmenden certifikata modulare), pastaj përmenden edhe niveli i kalueshmërisë dhe vlerësimi;
- Organizimi i mësimit gjatë fundjavës, infrastruktura e domosdoshme për disa profile arsimore, përvoja disa vjeçare në ofrimin e arsimit dhe aftësimit profesional për të rritur, staf të kualifikuar dhe me përvojë, infrastrukturë solide për zhvillimin e kurseve, dy programe të gatshme të hartuara nga njëra nga shkollat, pastaj është përmendur edhe përvoja nga platforma online që kanë me ARr që mund të konsiderohen si rrethana lehtësuese.

Më e rëndësishmja, nga ky hulumtim rezulton se tri profilet që kërkohen më së shumti në treg janë:

- Instalues Elektrik,
- Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit dhe
- Ndërtimtar (murator, fasader).